



EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME

Udhëzues rreth nenit 3 të Protokollit nr. 1
të Konventës Evropiane
të të Drejtave të Njeriut

E drejta për zgjedhje të lira

Përditësuar më 30 prill 2017

Botuesit ose organizatat që dëshirojnë ta përkthejnë dhe/ose ta riprodhojnë të plotë a pjesërisht këtë raport, në trajtë botimi të shtypur apo elektronik (në internet), janë të lutur t'i drejtohen publishing@echr.coe.int për t'u njohur me formalitetet e dhënies së lejes.

Për çdo informacion se cilat përkthime të udhëzuesve rreth jurisprudencës janë në përgatitje e sipër, jeni të lutur të shihni dokumentin [Përkthime në proces](#).

Ky udhëzues është përgatitur nga Drejtoria e Këshilltarit Juridik dhe nuk e kushtëzon Gjykatën. Atij mund t'i bëhen rishikime në redaktim.

I botuar për herë të parë në maj 2016, ky udhëzues përditësohet me rregullsi, në varësi të zhvillimit të jurisprudencës. Përditësimi i fundit është bërë më 30 prill 2017.

Udhëzuesi mund të shkarkohet nga interneti në adresën e mëposhtme: www.echr.coe.int (Case-law – Case-law analysis – Case-law guides). Për çdo informacion të ri lidhur me botimet, jeni të lutur të shihni llogarinë Twitter të Gjykatës: <https://twitter.com/echrpublication>.

Ky përkthim është publikuar në marrëveshje me Këshillin e Evropës dhe Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Përkthimi është financuar dhe është përgjegjësia e vetme e Programit të Përbashkët të BE/KiE "Rritja e Efektivitetit të Sistemit Shqiptar të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Anti-diskriminimit".

© Këshilli i Evropës/Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2017

Tryeza e lëndës

Njoftim për lexuesin	4
I. Parime të përgjithshme	5
A. Kuptimi dhe fusha e veprimit	5
B. Parime interpretimi.....	6
II. Aspekti aktiv: e drejta e votës	7
A. Heqja e të drejtave civile	8
B. Rasti i veçantë i të burgosurve.....	9
C. Vendbanimi, kusht për qasje tek e drejta e votës	10
1. Vota e qytetarëve jo me banim brenda territorit.....	10
2. Rasti i veçantë i disa territoreve	11
3. Organizimi material i votimit për personat jo me banim aty	12
III. Aspekti pasiv: e drejta për të qenë kandidat në zgjedhje.....	13
A. Pamundësia për të qenë kandidat dhe rendi demokratik.....	14
B. Rëndësia e kontekstit historik.....	14
C. Organizimi i jetës politike.....	15
1. Sigurimi i seriozitetit të kandidaturave: rregulli i depozitës së garancisë	16
2. Shmangia e një copëzimi të tepruar të peizazhit politik.....	16
D. Qëllimet e tjera të drejta	19
E. Nga fushata zgjedhore... ..	20
F. ... te ushtrimi i mandatit.....	22
IV. Mosmarrëveshjet zgjedhore	23
Lista e çështjeve të cituara.....	26

Njoftim për lexuesin

Ky udhëzues bën pjesë në serinë e Udhëzuesve rreth Jurisprudencës të botuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (më tej “Gjykata”, “Gjykata Evropiane” ose “Gjykata e Strasburgut”), me qëllimin për t’i informuar specialistët e së drejtës për vendimet themelore të dhëna prej saj. Në këtë rast, ky udhëzues analizon e përmbledh jurisprudencën lidhur me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (më tej “Konventa” ose “Konventa Evropiane”) deri më 30 prill 2017. Lexuesi do të gjejë aty parimet kyç të përpunuara në këtë fushë si edhe precedentët përkatës.

Jurisprudenca e cituar është zgjedhur midis vendimeve pilote, të rëndësishme dhe/ose të kohëve të fundit*.

Vendimet e Gjykatës jo vetëm japin gjykim për çështjet që i paraqiten asaj, por shërbejnë gjithashtu edhe më gjerë për të qartësuar, ruajtur e zhvilluar normat e Konventës; ato japin kështu ndihmesë për respektimin, nga ana e shteteve, të zotimeve që këto kanë marrë në cilësinë e tyre si Palë Kontraktuese (*Irlanda k. Mbretërisë së Bashkuar*, 18 janar 1978, § 154, seria A nr. 25). Sistemi i krijuar nga Konventa ka pra si qëllim që të japë gjykim, në interesin e përgjithshëm, për pikat që i përkasin rendit publik, duke i ngritur më lart normat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe duke zgjeruar jurisprudencën në këtë fushë tek e tërë bashkësia e Shteteve Palë në Konventë (*Konstantin Markin k. Rusisë* [DhM], nr. 30078/06, § 89, GjEDNj 2012).

Ky udhëzues përmban referimin e fjalëve kyç për secilin nen të cituar të Konventës ose të Protokolleve të saj shpesh. Pikat juridike të trajtuara në secilën çështje janë sintetizuar në një [Listë fjalësh kyç](#), të zgjedhura nga një fjalës termash të nxjerrë drejtpërdrejt (më së shumti) nga teksti i Konventës dhe i Protokolleve të saj.

[Baza e të dhënave HUDOC](#) e jurisprudencës së Gjykatës jep mundësi për të bërë kërkime me anë fjalësh kyç. Kërkimi me këto fjalë kyç do t’ju lejojë kështu të gjeni një grup dokumentesh me një përmbajtje të ngjashme juridike (arsyetimi dhe konkluzionet e Gjykatës për secilën çështje janë përmbledhur me anë fjalësh kyç). Fjalët kyç për secilën çështje mund të gjenden në skedën Hollësitë e Çështjes. Të gjitha shpjegimet e nevojshme do t’i gjeni te [manuali i përdorimit HUDOC](#).

* Jurisprudenca e cituar mund të jetë në njërin dhe/ose në tjetrën nga dy gjuhët zyrtare (frëngjisht dhe anglisht) të Gjykatës dhe të Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut. Me përjashtim të ndonjë shënimi të veçantë të vënë në dukje pas emrit të çështjes, referenca e cituar është ajo e një vendimi për themelin të dhënë nga një dhomë e Gjykatës. Shënimi “(vend. pran.)” shpie te një vendim i Gjykatës për pranueshmërinë, kurse shënimi “[DhM]” do të thotë se çështja është shqyrtuar nga Dhoma e Madhe.

I. Parime të përgjithshme

Neni 3 i Protokollit nr. 1 – E drejta për zgjedhje të lira

“Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë, në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.”

Fjalë kyç HUDOC

E drejtë për zgjedhje të lira (P1-3) – Zgjedhje periodike (P1-3) – Zgjedhje me votim të fshehtë (P1-3) – Shprehje e lirë e mendimit të popullit (P1-3) – Zgjedhje e organit ligjvënës (P1-3) – Votim (P1-3) – Vë kandidaturën në zgjedhje (P1-3)

A. Kuptimi dhe fusha e veprimit

1. “Sipas hyrjes së Konventës, ruajtja e lirive themelore “mbështetet kryesisht mbi një regjim politik me të vërtetë demokratik”. Duke sanksionuar një parim karakteristik të një regjimi të tillë, neni 3 i Protokollit nr. 1 merr pra një rëndësi kryesore në sistemin e Konventës.” (*Mathieu-Mohin e Clerfayt k. Belgjikës*, § 47).

2. Neni 3 i Protokollit nr. 1 ka të bëjë vetëm me zgjedhjen e organit ligjvënës. Megjithatë, kjo shprehje nuk kufizohet vetëm te parlamenti kombëtar. E mira është të shqyrtohet struktura kushtetuese e shtetit në fjalë (*Timke k. Gjermanisë*, vendim i Komisionit). Në një mënyrë të përgjithshme, në fushën e zbatimit të nenit 3 të Protokollit nr. 1 nuk hyjnë zgjedhjet vendore, qofshin ato bashkiake (*Xuereb k. Maltës*; *Salleras Llinares k. Spanjës*) ose rajonale (*Malarde k. Francës*). Gjykata ka gjykuar në fakt se fuqia për të nxjerrë rregullore dhe akte administrative, e cila u njihet autoriteteve vendore në shumë vende, dallon nga pushteti ligjvënës që ka parasysh neni 3 i Protokollit nr. 1, edhe pse pushteti ligjvënës nuk duhet të kuptohet medoemos sikur ka të bëjë vetëm me parlamentet kombëtare (*Mólka k. Polonisë* (vend. pran.)).

Lidhur me zgjedhjet presidenciale, Gjykata ka qenë e mendimit se të drejtat e posaçme të kreut të shtetit nuk mund të bëjnë, si të tilla, që ky i fundit të shihet si “organ ligjvënës” në kuptimin e nenit 3 të Protokollit nr. 1. Megjithatë, ajo nuk e përjashton mundësinë që ta zbatojë nenin 3 të Protokollit nr. 1 për zgjedhje presidenciale. Po të vërtetohej që funksionet e kreut të shtetit në fjalë përfshijnë nismën ligjvënëse dhe fuqinë për të miratuar ligje apo përmbajnë të drejta të gjera të posaçme në fushën e kontrollit të miratimit të ligjeve ose fuqinë për të censuruar organet kryesore ligjvënëse, atëherë do të mund të mbrohej mendimi se kreu i shtetit është një “organ ligjvënës” në kuptimin e nenit 3 të Protokollit nr. 1 (*Bošković k. ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* (vend. pran.); *Brito Da Silva Guerra e Sousa Magno k. Portugalisë* (vend. pran.)). Sidoqoftë, kjo mundësi nuk është shfrytëzuar ende asnjëherë dhe as që është përmendur fare në çështjet e mëvonshme (*Paksas k. Lituanisë* [DhM]; *Anchugov e Gladkov k. Rusisë*, §§ 55-56).

3. Por, nga ana tjetër, Gjykata ka çmuar disa herë se Parlamenti Evropian përbënte një pjesë të organit ligjvënës në kuptimin e nenit 3 të Protokollit nr. 1 (*Matthews k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], §§ 45-54; *Occhetto k. Italisë* (vend. pran.), § 42).

4. Për sa u përket vetë karakteristikave të votimit, teksti i nenit 3 të Protokollit nr. 1 parashikon vetëm karakterin e tij të lirë dhe të fshehtë, çka është përsëritur vazhdimisht nga Komisioni e pastaj nga Gjykata (*X. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Komisionit i 6 tetorit 1976). Ai saktëson përveç kësaj se zgjedhjet duhet të mbahen në intervale të arsyeshme kohore. Shtetet gëzojnë në këtë fushë një hapësirë të gjerë vlerësimi. Jurisprudenca ka treguar sidoqoftë disa vija udhëheqëse:

“Karakterit i rregullt i intervaleve kohore ndërmjet zgjedhjeve parlamentare duhet të vlerësohet në dritën e objektit të këtyre zgjedhjeve, domethënë të garantojë që idetë e përfaqësuesve të popullit të shprehin zhvillimet themelore të mendimit mbizotërues. Në parim, parlamenti duhet të jetë në gjendje të hartojë dhe të vërë në zbatim programe në fushën e ligjvënies, duke përfshirë edhe projekte afatgjata. Një interval kohor tepër i shkurtër midis zgjedhjeve do të mund t’i pengonte strategjitë politike të cilat synojnë të vënë në jetë dëshirat e zgjedhësve. Një interval kohor tepër i gjatë mund të çojë në mungesë ripërtëritjeje të përfaqësimit parlamentar, i cili ka rrezik që, me kalimin e kohës, të mos u përgjigjet më aspiratave mbizotëruese të zgjedhësve.” (*Timke k. Gjermanisë*, vendim i Komisionit)

5. Jurisprudenca e Gjykatës ka shtjelluar kërkesën për një karakter të përgjithshëm të votimit, i cili është tashmë parimi i referencës (*X. k. Gjermanisë*, vendim i Komisionit; *Hirst k. Mbretërisë së Bashkuar (nr. 2)* [DhM], §§ 59 e 62; *Mathieu-Mohin e Clerfayt k. Belgjikës*, § 51). Por, nga ana tjetër, ajo çmon se, sado që neni 3 i Protokollit nr. 1 e nënkupton parimin e barazisë së trajtimit të të gjithë qytetarëve në ushtrimin e së drejtës së tyre të votës, prapëseprapë kjo nuk do të thotë se të gjitha votat duhet të kenë një peshë të barabartë për sa i takon rezultatit. Kështu, asnjë sistem nuk e shmang dot dukurinë e “votave të shkuara dëm” (*po aty*, § 54, *Partija “Jaunie Demokrāti” e Partija “Mūsu Zeme” k. Letonisë* (vend. pran.)).

6. Megjithatë, çdo votuesi duhet t’i jepet mundësia që vota e tij të ndikojë në përbërjen e organit ligjvënës, përndryshe e drejta për të votuar, procesi zgjedhor dhe, në fund të fundit, vetë rendi demokratik zbrazen nga substanca e tyre (*Riza me të tjerë k. Bullgarisë*, § 148). Shtetet gëzojnë pra një hapësirë të gjerë vlerësimi në mënyrën e organizimit të votimit. Kështu, një ndarje e pabarabartë zonash zgjedhore për sa i përket popullsisë nuk përbën shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 për sa kohë që nuk e dëmton saktësinë e shprehjes së vullnetit të popullit (*Bompard k. Francës* (vend. pran.)). Së fundi, zgjedhja e mënyrës së votimit përmes të cilës sigurohet shprehja e lirë e mendimit të popullit lidhur me zgjedhjen e organit ligjvënës – përfaqësim proporcional, votë mazhoritare apo tjetër – është një pikë për të cilën secili shtet gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi (*Matthews k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], § 64).

B. Parime interpretimi

7. Neni 3 i Protokollit nr. 1 ndryshon nga dispozitat e tjera të Konventës dhe të Protokolleve të saj të cilat garantojnë të drejta, sepse ai parashtron detyrimin që kanë shtetet anëtare për të organizuar zgjedhje brenda kushtesh që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit dhe jo ndonjë të drejtë apo liri në veçanti. Megjithatë, duke pasur parasysh punimet përgatitore të nenit 3 të Protokollit nr. 1 dhe interpretimin që i është dhënë kësaj klauzole në suazën e Konventës në tërësi, Gjykata ka përcaktuar se ky nen nënkupton gjithashtu disa të drejta subjektive, ndër të cilat të drejtën për të votuar (aspekti “aktiv”) dhe atë për të qenë kandidat për zgjedhje (aspekti “pasiv”) (*Mathieu-Mohin e Clerfayt k. Belgjikës*, §§ 48-51; *Ždanoka k. Letonisë* [DhM], § 102).

8. Të drejtat në fjalë nuk janë absolute. Në to ka vend për disa “kufizime të nënkuptuara”, dhe Shteteve Kontraktuese duhet t’u lihet një hapësirë për vlerësim në këtë lëmë. Nocioni “kufizim i nënkuptuar” që del prej nenit 3 të Protokollit nr. 1 merr një rëndësi madhore kur është fjala për të përcaktuar drejtësinë e qëllimeve të ndjekura nga kufizimet ndaj të drejtave të garantuara nga kjo dispozitë. Meqenëse neni 3 i Protokollit nr. 1 nuk është i kufizuar me ndonjë listë të përpiktë “kufizimesh të nënkuptuara”, si ato që përmenden një për një në nenet 8 deri 11 të Konventës, Shtetet Kontraktuese mund të mbështeten kështu lirisht te një qëllim i cili nuk figuron në këtë listë për të përligjur një kufizim, me kusht që të vërtetohet pajtueshmëria e këtij qëllimi me parimin e mbisundimit të ligjit dhe me objektivat e përgjithshëm të Konventës në rrethanat e veçanta të një çështjeje të caktuar.

9. Nocioni “kufizim i nënkuptuar” do të thotë gjithashtu se Gjykata nuk i zbaton kriteret tradicionale të “domosdoshmërisë” ose të “nevojës së ngutshme shoqërore” që përdoren në suazën e neneve 8 deri në 11 të Konventës. Kur i duhet të shqyrtojë pika rreth përputhshmërisë me nenin 3 të Protokollit nr. 1, Gjykata kapet kryesisht pas dy kriteresh: ajo sheh në njërin anë se mos ka pasur

arbitraritet ose mungesë përpjesëtueshmërie, dhe në anën tjetër se mos kufizimi e ka cenuar shprehjen e lirë të mendimit të popullit. Përveç kësaj, ajo thekson nevojën për ta vlerësuar secilin legjislacion zgjedhor në dritën e ecuresë politike të vendit në fjalë, çka nënkupton që disa karakteristika të papranueshme në suazën e njërit sistem mund të përligjen në kontekstin e një tjetri (*Mathieu-Mohin e Clerfayt k. Belgjikës*, § 52; *Ždanoka k. Letonisë* [DhM], §§ 103-104 et 115).

10. E drejta për t'u paraqitur në zgjedhjet legjislative (aspekti "pasiv") mund të përfshihet brenda një kornize me kërkesa më të rrepta se sa e drejta e votës (aspekti "aktiv"). Ndërkohë që kriteri relativ i aspektit "aktiv" të nenit 3 të Protokollit nr. 1 nënkupton zakonisht një vlerësim më të gjerë të përpjesëtueshmërisë së dispozitave ligjore që ia heqin një personi a një grupi personash të drejtën e votës, qasja e zgjedhur për sa i përket aspektit "pasiv" kufizohet në thelb vetëm duke verifikuar mungesën e arbitraritetit në procedurat e brendshme që shpjen në heqjen e mundësisë për t'u zgjedhur për një individ (*po aty*, § 115; *Melnitchenko k. Ukrainës*, § 57).

11. Për sa i përket asaj se kush mund të kërkojë të përfitojë lidhur me një shkelje të pretenduar të këtij aspekti pasiv, Gjykata ka pranuar se, kur legjislacioni zgjedhor ose masat e marra nga autoritetet kombëtare ua kufizojnë të drejtën kandidatëve të marrë individualisht për t'u paraqitur në një palë zgjedhje në listën e një partie, atëherë partia e interesuar ka mundësi që, në këtë cilësi, të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje të nenit 3 të Protokollit nr. 1, në mënyrë të pavarur nga kandidatët e saj (*Partia e Punës e Gjeorgjisë k. Gjeorgjisë*, §§ 72-74; *Riza me të tjerë k. Bullgarisë*, § 142).

12. Së fundi, kur ia nënshtron sistemin zgjedhor të një vendi shqyrtimit të saj – lidhur qoftë me aspektin aktiv, qoftë me atë pasiv –, Gjykata e merr parasysh larminë e konteksteve historike të shteteve. Këto kontekste të ndryshme mund të shpjen kështu në pranimin e disa divergjencave në rregullat e së drejtës zgjedhore nga njëri vend në tjetrin, por gjithashtu edhe në shpjegimin e evoluimit të nivelit të kërkesës në varësi të periudhave të marra në shqyrtim.

II. Aspekti aktiv: e drejta e votës

13. Aspektit "aktiv" mund t'i bëhen kufizime. Edhe këtu, ashtu si për çdo fushë tjetër që ka të bëjë me nenin 3 të Protokollit nr. 1, shtetet anëtare gëzojnë njëfarë hapësire vlerësimi e cila ndryshon sipas kontekstit. Për shembull, është e mundur të caktohet një moshë minimale për t'u siguruar që personat të cilët marrin pjesë në procesin zgjedhor të kenë pjekuri të mjaftueshme (*Hirst k. Mbretërisë së Bashkuar (nr. 2)* [DhM], § 62).

14. Mirëpo, kontrolli i ushtruar është një kontroll përpjesëtueshmërie relativisht i thelluar. Hapësira për vlerësim që u njihet shteteve nuk mund të ketë si efekt që t'ua ndalojë disa personave a disa grupeve të marrin pjesë në jetën politike të vendit, sidomos përmes emërimit të anëtarëve të organit ligjvënës (*Aziz k. Qipros*, § 28; *Tănase k. Moldavisë* [DhM], § 158). Në çështjen *Aziz k. Qipros*, Gjykata është shprehur rreth ndalimit të bërë ndaj pjesëtarëve të komunitetit qipriot turk për të votuar në zgjedhjet legjislative. Ajo ka qenë e mendimit se, për shkak të situatës anormale që ekziston në Qipro që prej vitit 1963 si edhe të zbrazëtirës legjislative, paditësit, si pjesëtar i komunitetit qipriot turk me vendbanim në Republikën e Qipros, i është hequr çdo lloj mundësie për të shprehur mendimin e tij në kuadër të zgjedhjes së anëtarëve të Dhomës së Përfaqësuesve. Për rrjedhojë, është marrë nëpër këmbë vetë thelbi i së drejtës së tij të votës. Gjykata ka vënë re gjithashtu një pabarazi të hapur trajtimi në gëzimin e së drejtës së votës midis pjesëtarëve të komunitetit qipriot turk dhe atyre të komunitetit qipriot grek. Ajo ka dalë kështu në konkluzionin se ka pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 më vete dhe të bashkuar me nenin 14 të Konventës.

15. Vihet re nga ana tjetër se, ndonëse disa ankesa që kanë të bëjnë me zgjedhje nuk hyjnë në fushën e veprimit të nenit 3 të Protokollit nr. 1, ato mund të ngrihen, nëse është rasti, në

këndvështrimin e disa neneve të tjera të Konventës. Kështu në çështjen *Mólka k. Polonisë*, paditësi ishte gjendur në pamundësinë për të votuar në zgjedhje që kishin të bënin me këshillat bashkiake, këshillat e rretheve dhe kuvendet rajonale. Qendra e votimit nuk kishte mundësi qasjeje për personat me ndenjësë me rrota dhe nuk lejohej që një fletë votimi të nxirrej jashtë lokaleve të qendrës së votimit. Gjykata që e mendimit se nuk mund të përjashtohet që mospajtimi nga ana e administratës të një mundësie të përshtatshme qasjeje në qendrën e votimit në favor të paditësit, i cili dëshironte të bënte një jetë aktive, të mund të ngjallte ndjenja poshtërime e tronditjeje të tilla që ta cenonin autonominë personale të të interesuarit e, për rrjedhojë, edhe cilësinë e jetës së tij private. Gjykata e pranoi kështu hipotezën që, në rrethana të tilla, të hyjë në veprim neni 8.

A. Heqja e të drejtave civile

16. Kur një personi a një grupi personash u është hequr e drejta e votës, Gjykata tregohet veçanërisht e vëmendshme. Heqja e së drejtës së votës duhet t'i shërbejë atëherë një qëllimi të drejtë, por edhe t'i përgjigjet një kërkesë të lartë për përpjesëtueshmëri. Gjykata ka marrë kështu në shqyrtim disa çështje në të cilat heqja e së drejtës së votës përfshihej brenda suazës së një hetimi penal. Në çështjen *Labita k. Italisë* [DhM] bëhej fjalë për heqjen e përkohshme automatike të të drejtave civile në rastin e një individi të dyshuar se i përkiste mafies. Gjykata e ka pranuar se një masë e tillë ndiqte një qëllim të drejtë. Megjithatë, duke marrë parasysh faktin se kjo masë ishte zbatuar vetëm pas pushimit të çështjes penale ndaj paditësit, ajo ka qenë e mendimit se nuk ekzistonte asnjë element konkret që të lejonte të dyshohej se ai i përkiste mafies dhe se masa e kundërshtuar ishte për pasojë e shpërpjesëtuar. Në çështjen *Vito Sante Santoro k. Italisë*, paditësi i ishte hequr gjithashtu e drejta e votës për një periudhë të kufizuar, për arsye të vënies së tij nën mbikëqyrje policore. Megjithatë, kishin kaluar më shumë se nëntë muaj ndërmjet urdhrit për vënie nën mbikëqyrje dhe heqjes nga listat zgjedhore. Për shkak të këtij veprimi, paditësi ishte penguar të votonte në dy zgjedhje, çka nuk do të kishte ndodhur në qoftë se ajo masë do të ishte zbatuar menjëherë. Mirëpo qeveria nuk kishte paraqitur asnjë arsye që ta përligjte afatin në fjalë. Gjykata doli pra në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1.

17. Pika e heqjes së të drejtave civile nuk shtrohet vetëm në një kontekst penal. Në çështjen *Albanese k. Italisë* bëhej fjalë për pezullimin e ushtrimit të të drejtave zgjedhore të paditësit gjatë të gjithë periudhës së procedurës për falimentim të nisur ndaj tij. Gjykata nënvizoi se procedura për falimentim nuk i përkiste së drejtës penale, por së drejtës civile, dhe nuk përmbante asnjë nocion mashtrimi apo kundërvajtjeje nga ana e të falimentuarit. Kufizimi i të drejtave zgjedhore të këtij të fundit ndiqte pra një qëllim me karakter kryesisht ndëshkimor. Prandaj, ai kishte si qëllim të vetëm që ta poshtëronte të falimentuarin dhe përbënte një qortim moral për të vetmin fakt se ai ishte në paaftësi për të paguar, pavarësisht nga çdolloj fajësie. Gjykata doli andej në konkluzionin se kjo masë nuk ndiqte një qëllim të drejtë në kuptimin e nenit 3 të Protokollit nr. 1.

18. Gjykatës i është dashur gjithashtu të interesohet lidhur me heqjen e së drejtës së votës për shkak të një vënie nën kujdestari të pjeshme (*Alajos Kiss k. Hungarisë*). Ajo ka çmuar se një masë e tillë mund të ndiqte një qëllim të drejtë, konkretisht të garantonte që në çështjet publike të marrin pjesë vetëm qytetarët e aftë për t'i vlerësuar pasojat e vendimeve të tyre dhe për të marrë vendime të vetëdijshme e të arsyeshme. Mirëpo, ndalimi për të votuar imponohej në mënyrë automatike e të përgjithshme, pa i marrë parasysh aftësitë reale të personit të mbrojtur dhe pa e bërë dallimin midis kujdestarisë së plotë ose të pjeshme. Gjykata ka saktësuar se ishte diçka e diskutueshme që personat e prekur nga paaftësi mendore ose psikike të trajtoheshin si një grup i vetëm dhe se kufizimi i të drejtave të tyre duhej t'i nënshtrohej një kontrolli të rreptë. Ajo ka nxjerrë andej konkluzionin se heqja e së drejtës së votës, pa vlerësim gjyqësor të individualizuar të situatës së të interesuarve, nuk ishte në përpjesëtim me qëllimin e synuar.

B. Rasti i veçantë i të burgosurve

19. Personat e burgosur në përgjithësi vazhdojnë t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga Konventa, me përjashtim të së drejtës për lirinë kur një ndalim i ligjshëm hyn shprehimisht në fushën e zbatimit të nenit 5 të Konventës (*Hirst k. Mbretërisë së Bashkuar (nr. 2)* [DhM], § 69). Të drejtat e garantuara nga neni 3 i Protokollit nr. 1 nuk bëjnë përjashtim. Pra nuk bëhet aspak fjalë që një të burgosuri t'i hiqen të drejtat e garantuara nga Konventa thjesht për faktin që ai gjendet i burgosur si pasojë e një dënimi. Kjo nuk pengon që të merren masa për ta mbrojtur shoqërinë nga disa veprimtari që synojnë t'i shkatërrojnë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë.

20. Neni 3 i Protokollit nr. 1 nuk e përjashton pra që t'i bëhen disa kufizime të të drejtave zgjedhore një individ që, për shembull, ka kryer shpërdorime të rënda në ushtrimin e funksioneve publike apo sjellja e të cilit ka kërcënuar të minojë shtetin ligjor ose themelet e demokracisë. Megjithatë, ajo masë e rreptë që përbën heqja e së drejtës së votës nuk duhet të përdoret me mendjelehtësi; për më tepër, parimi i përpjesëtueshmërisë kërkon që të ekzistojë një lidhje e dallueshme dhe e mjaftueshme ndërmjet sanksionit dhe sjelljes si edhe situatës së personit të prekur (*po aty*, § 71).

21. Që një të burgosuri t'i hiqen të drejtat e tij politike, kjo mund t'u përgjigjet pra disa qëllimeve të drejta siç janë parandalimi i krimit, forcimi i ndjenjës qytetare dhe i respektimit të shtetit ligjor, si edhe mirëfunksionimi e ruajtja e demokracisë. Mirëpo një masë e tillë nuk mund të caktohet automatikisht, përndryshe ajo do të binte ndesh me kërkesën për përpjesëtueshmëri.

22. Shtetet mund të vendosin që t'ia besojnë gjyqtarit kujdesin për të vlerësuar përpjesëtueshmërinë e një mase kufizuese të së drejtës së votës të të burgosurve të dënuar ose që t'i përfshijnë në ligj disa dispozita ku përcaktohen rrethanat në të cilat gjen vend për t'u zbatuar një masë e tillë. Në rastin e kësaj hipoteze të dytë, është vetë ligjvënësi ai që i vë në balancë interesat konkurruese me qëllim për të shmangur çdolloj ndalimi të përgjithshëm, automatik dhe me zbatim të padiferencuar. Pra, zbatimi i një ndalimi të së drejtës së votës në mungesë të një vendimi të posaçëm gjyqësor nuk përbën në vetvete ndonjë shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 (*Scoppola k. Italisë (nr. 3)* [DhM], § 102).

23. Në çështjen *Hirst k. Mbretërisë së Bashkuar (nr. 2)* [DhM], Gjykata ka vënë re një shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 për arsye se ndalimi për të votuar zbatohet në mënyrë automatike e të përgjithshme ndaj çdo personi që vuante një masë dënimi me heqje lirie. Ai prekte 48 000 të burgosur, çka përbën një numër të lartë, dhe kishte të bënte me çdolloj dënimesh me burgim, të cilat shkonin nga një ditë deri në burgim të përjetshëm, dhe veprash penale, të cilat shkonin nga akte relativisht të vogla deri tek aktet më të rënda. Për më tepër, nuk dukej të kishte asnjë lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet akteve të kryera nga një individ dhe heqjes të së drejtës së tij të votës. Gjykata doli gjithashtu në përfundimin se kishte shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 në çështjen *Söyler k. Turqisë* ku kufizimet e imponuara ndaj së drejtës për votë të personave të dënuar me një masë burgimi kishin shtrirje dhe ndikim akoma më të madh përderisa zbatoheshin edhe ndaj atyre të cilët nuk e vuanin dënimin e tyre me burgim. Në çështjen *Frodl k. Austrisë*, heqja e së drejtës së votës nuk i synonte sistematikisht të gjithë të burgosurit, por vetëm ata të cilëve u ishte dhënë një dënim me burgim më shumë se një vit për një vepër penale të kryer me dashje. Megjithatë, nuk ekzistonte ndonjë lidhje ndërmjet caktimit automatik të masës së kundërshtuar dhe sjelljes së individit apo rrethanave të çështjes. Gjykata doli pra në konkluzionin se heqja e së drejtës së votës nuk ishte në përpjesëtim me qëllimet e synuara.

24. Ndërsa në çështjen *Scoppola k. Italisë (nr. 3)* [DhM], Gjykatës i duhej të shqyrtonte një ndalim të së drejtës së votës i cili zbatohet vetëm për personat e dënuar për disa vepra penale të mirëpërcaktuara ose me një dënim me heqje lirie gjatësia e të cilit ishte përtej një pragu të caktuar me ligj. Ligjvënësi ishte kujdesur ta përshtaste përdorimin e kësaj mase në varësi të veçorive të secilës çështje. Ai e kishte përshtatur gjithashtu kohëzgjatjen e masës së ndalimit në varësi të

dënimet të dhënë e kështu, tërthorazi, edhe të seriozitetit të veprës penale. Ishin të shumtë të burgosurit e dënuar të cilët e kishin ruajtur mundësinë për të votuar në zgjedhjet legislative. Përveç kësaj, ky sistem ishte plotësuar me mundësinë që u ofrohej të dënuarve të ndëshkuar me një ndalim të formës së prerë të së drejtës së votës për ta fituar rivendosjen e kësaj të fundit. Pra, sistemi italian nuk vuante nga ndonjë ngurtësi e tepruar. Për rrjedhojë, Gjykata doli në konkluzionin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1.

25. Duhet të shënohet megjithatë se, që të mund të vihet re një shkelje e nenit 3 të Protokollit nr. 1, të burgosurit duhet të tregojnë se janë penguar me të vërtetë për të votuar. Nuk është e mjaftueshme që ata të nxjerrin si argument burgimin e tyre *a priori*, përderisa përpara mbajtjes së zgjedhjeve në fjalë mund të ndodhin disa ngjarje të tilla si një lirim para kohe, një shtrim në spital psikiatrik, etj. Kërkesëpadi të tilla shpallen pra të papranueshme si haptazi të pabazuara (*Dunn me të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar* (vend. pran.)).

26. Për më tepër, Gjykata nuk e ka parë asnjëherë si të përshtatshme që t'u tregojë shteteve se cilat janë masat e nevojshme për t'u dhënë fund shkeljeve të shkaktuara nga ndalimi i votës së të burgosurve. Shumë-shumë ajo ka mundur të tregojë një kalendar (*Greens e M.T. k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 120). Nga ana tjetër, shtetet nuk mund të nxjerrin si argument natyrën e ndërlikuar të procedurës që u dashka për ta ndryshuar të drejtën në zanafillë të shkeljes. Në çështjen *Anchugov e Gladkov k. Rusisë*, Gjykata e mbajti shënim argumentin sipas të cilit ndalimi diktohej nga një dispozitë e Kushtetutës e cila nuk mund të ndryshohej nga Parlamenti e mund të rishikohej vetëm përmes miratimit të një Kushtetute të re, çka do të nënkuptonte një procedurë veçanërisht të ndërlikuar. Megjithatë, ajo rikujtoi se u takonte kryesisht autoriteteve që të zgjidhnin, nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave, mjetet që duhej të përdreshin për ta vënë legjislacionin në përputhje me Konventën. Qeveritë e kanë vetë në dorë t'i provojnë të gjitha rrugët e mundshme për të siguruar respektimin e nenit 3 të Protokollit nr. 1, qoftë edhe përmes ndonjë trajte procesi politik a ndonjë interpretimi të Kushtetutës në përputhje me Konventën (*po aty*, § 111).

C. Vendbanimi, kusht për qasje tek e drejta e votës

1. Vota e qytetarëve jo me banim brenda territorit

27. Në një varg çështjesh që zënë fill më 1961, Komisioni i ka shpallur të papranueshme, si haptazi të pabazuara, ankesat për kufizime të së drejtës së votës të mbështetura mbi një kriter vendbanimi (shih vendimet e Komisionit: *X. me të tjerë k. Belgjikës*; *X. k. Mbretërisë së Bashkuar* (11 dhjetor 1976); *X. k. Mbretërisë së Bashkuar* (28 shkurt 1979); *X. k. Mbretërisë së Bashkuar* (13 maj 1982); *Polacco e Garofalo k. Italisë*; *Luksch k. Gjermanisë*).

28. Më pas, Gjykata e ka përsëritur pajtueshmërinë e imponimit të një kriteri vendbanimi me nenin 3 të Protokollit nr. 1. Atë mund ta përligjin disa arsye: së pari, prezumimi se një qytetar jo me banim aty është i interesuar më pak drejtpërsëdrejti ose më pak vazhdimisht për problemet e përditshme të vendit të tij si edhe i njeh më pak ato; së dyti, kandidatët për zgjedhjet legislative nuk kanë kurrfarë mundësie që t'ua paraqesin sfidat e ndryshme zgjedhore qytetarëve që ndodhen jashtë shtetit dhe këta të fundit kanë më pak ndikim në përzgjedhjen e kandidatëve apo në përcaktimin e programeve të tyre zgjedhore; së treti, lidhja e ngushtë ndërmjet së drejtës së votës në zgjedhjet legislative dhe faktit që prelesh drejtpërdrejt nga aktet e organeve politike të zgjedhura në këtë mënyrë; dhe, së katërti, shqetësimi i drejtë që mund të ketë ligjvënësi për ta kufizuar ndikimin e qytetarëve me banim jashtë shtetit mbi zgjedhje që kanë të bëjnë me disa pika të cilat, ndonëse duke qenë sigurisht themelore, prekin në radhë të parë personat që janë me banim brenda vendit.

29. Edhe sikur personi i interesuar të mos i ketë shkëputur ndoshta lidhjet me vendin e tij të prejardhjes e sikur disa prej elementeve të sipërpërmendur, për rrjedhojë, të mos kenë mbase të bëjnë me të, ligji nuk mund të marrë gjithmonë parasysh secilin rast individual, por duhet të

parashtrojë një rregull të përgjithshëm (*Hilbe k. Lihtenshtajnit* (vend. pran.); *Doyle k. Mbretërisë së Bashkuar* (vend. pran.); *Shindler k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 105).

30. Gjykata i ka parë kështu si të pabazuara kërkesëpaditë e shtetasve që janë larguar nga vendi i tyre i prejardhjes (*Hilbe k. Lihtenshtajnit* (vend. pran.)). Në dy çështje, ajo ka marrë parasysh veçanërisht faktin se personat jo me banim aty mund të votonin për zgjedhjet kombëtare gjatë pesëmbëdhjetë vjetëve që pasonin emigrimin e tyre dhe se kjo e drejtë gjithsesi rivendosej në qoftë se të interesuarit ktheheshin për të jetuar në vendin e tyre të prejardhjes dhe ka nxjerrë andej përfundimin se masa nuk ishte e shpërpjesëtuar (*Doyle k. Mbretërisë së Bashkuar* (vend. pran.); *Shindler k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 108). Në këtë çështje të fundit, ajo e ka çmuar gjithashtu si me rëndësi faktin që parlamenti ishte përpjekur në disa raste të ndryshme për t'i vënë në balancë interesat konkurruese dhe e kishte debatuar me hollësi pikën lidhur me të drejtat e votës së personave jo me banim aty; mënyra se si ishin zhvilluar mendimet në Parlament gjente madje pasqyrim në ndryshimet që i ishin bërë periudhës së banimit që kurse ishte vendosur mundësia për të votuar për zgjedhësit me banim jashtë shtetit.

31. Në çështjen *Shindler k. Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata ka vënë re një vëmendje në rritje, në rrafsh evropian, ndaj problemeve që shtrihen migrimi nga pikëpamja e pjesëmarrjes politike në vendin e prejardhjes dhe në vendin e qëndrimit. Megjithatë, ajo ka çmuar se asnjë prej dokumenteve të shqyrtuara nuk lejonte të dilej në përfundimin se, në gjendjen e tanishme të së drejtës, shtetet ishin të detyruar t'u jepnin personave jo me banim aty një qasje të pakufizuar në të drejtën e votës. Po ashtu, ndonëse në të drejtën dhe praktikën e shteteve anëtare kishte pasur një prirje të qartë për ta lejuar votën e personave jo me banim aty dhe një shumicë e konsiderueshme shtetesh kishte qenë në favor të një të drejte të pakufizuar, prapëseprapë nuk mund të vihej ende re ekzistenca e një qasjeje të përbashkët apo e një konsensusi të favorshëm për një të drejtë të pakufizuar vote për personat jo me banim aty. Gjykata ka nxjerrë pra andej si konkluzion se, edhe pse ishte ndoshta me vend që të ndiqej kjo pikë, shtetet ruanin një hapësirë të gjerë për vlerësim në këtë fushë (*po aty*, §§ 109-115).

2. Rasti i veçantë i disa territoreve

32. Në çështjen *Py k. Francës*, Gjykata i rikthehet idesë së një lidhjeje mjaft të fuqishme midis votuesit potencial dhe territorit në fjalë. Një francezi me prejardhje nga metropoli i ishte mohuar e drejta për votë në zgjedhjet për Kongresin e Kaledonisë së Re me arsyetimin se ai nuk e përlligjte atë me të paktën 10 vjet banim në atë territor. Gjykata çmoi se pragjet e kohës së banimit i përgjigjeshin kujdesit për të garantuar që votimet të shprehnin vullnetin e popullsisë "të interesuara" e që rezultati i tyre të mos shtrembërohej përmes një vote masive të popullsisë të mbërritura kohët e fundit në atë territor e të cilat nuk përlligjin lidhje të qëndrueshme me të. Përveç kësaj, kufizimi i së drejtës së votës ishte pasoja e drejtpërdrejtë dhe e domosdoshme e vendosjes së një shtetësie kaledoniane. Aktet e organeve politike të Kaledonisë së Re nuk i drejtoheshin paditësit në të njëjtën shkallë si shtetasve me banim aty. Për rrjedhojë, kushti i vendbanimit ishte i përlligjur dhe ndiqte një qëllim të drejtë. Historia dhe statusi i Kaledonisë së Re – një fazë kalimtare para fitimit të sovranitetit të plotë dhe një proces vetëvendosjeje – u konsideruan si "domosdoshmëri lokale" të cilat mund ta përlligjin një kërkesë aq të lartë si 10 vjet banim aty, meqenëse ky kusht kishte përbërë për më tepër një element thelbësor për qetësimin e konfliktit vdekjeprurës.

33. Në çështjen *Sevinger k. Vendeve të Ulëta*, ishte në pikëpyetje pamundësia për personat me banim në ishullin e Arubës, i cili gëzonte njëfarë autonomie, për të votuar në zgjedhjet për Parlamentin holandez. Mirëpo ata mund të votonin në zgjedhjet për Parlamentin e ishullit, i cili dërgon delegatë në Parlamentin holandez. Gjykata ka qenë e mendimit se shtetasit holandezë me banim në Arubë mund të ndikonin në këtë mënyrë mbi vendimet e asamblesë së deputetëve dhe se, përveç kësaj, vendimet e miratuara nga Parlamenti holandez nuk i preknin ata në të njëjtën mënyrë si personat me banim në Vendet e Ulëta. Ajo e rrëzoi gjithashtu kërkesën e bërë mbi bazën e nenit 14 të bashkuar me nenin 3 të Protokollit nr. 1. Ajo çmoi se personat me banim në Arubë ishin të

vetmit që mund të votonin për Parlamentin e ishullit dhe nuk ishin pra në një situatë të njëjtë me atë të shtetasve të tjerë holandezë.

34. Për sa i përket organizimit gjeografik e territorial të votimit brenda territorit të shtetit në fjalë, Gjykata ka pranuar se detyrimi për të kërkuar heqjen nga lista e vjetër zgjedhore dhe ai për të kërkuar regjistrimin në një listë të re ndiqnin disa qëllime të drejta siç janë sigurimi i përcaktimit të listave zgjedhore në kushte të kënaqshme kohe dhe kontrolli, mundësimi i mbarëvajtjes së operacioneve të votimit dhe shmangia e manovrave mashtruese. Detyrimi për t'i respektuar këto formalitete brenda afatit të përcaktuar me rregullore përfshihet në ushtrimin e hapësirës së gjerë për vlerësim që ka shteti në këtë fushë (*Benkaddour k. Francës*).

3. Organizimi material i votimit për personat jo me banim aty

35. Neni 3 i Protokollit nr. 1 nuk ua vë shteteve në ngarkim detyrimin për të vendosur një sistem që mundëson ushtrimin e së drejtës së votës jashtë shtetit për qytetarët e çatdhesuar. Në çështjen *Sitaropoulos e Giakoumopoulos k. Greqisë* [DHM], paditësit ankoheshin se, në mungesë të rregullave rreth kësaj pike, ata nuk mund ta ushtronin të drejtën e tyre të votës nga vendi ku banonin jashtë atdheu (Franca) dhe kjo në një kohë kur Kushtetuta e vendit të tyre të prejardhjes (Greqia) e parashikonte këtë mundësi. Gjykata doli në konkluzionin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1, sepse shqetësimet me natyrë financiare, familjare e profesionale që do t'u ishin shkaktuar paditësve nëse do t'u ishte dashur të shkonin në vendin e tyre të prejardhjes për të votuar nuk dukeshin të shpërpjesëtuara deri në atë pikë sa ta cenonin të drejtën e tyre të votës.

36. Mirëpo, në qoftë se e drejta kombëtare e parashikon një sistem të tillë, nga kjo mund të rrjedhin disa detyrime specifike, sidomos ai për t'i përsëritur zgjedhjet në territorin e huaj nëse është nevoja. Në çështjen *Riza me të tjerë k. Bullgarisë*, Gjykata ka pohuar se e mbante parasysh që organizimi i zgjedhjeve të reja në territorin e një vendi tjetër sovran, qoftë edhe në një numër të kufizuar qendrash votimi, mund të ndeshte pengesa të mëdha diplomatike ose operative dhe të sillte kosto shtesë. Megjithatë, ajo ka çmuar se mbajtja e zgjedhjeve të reja, në një qendër votimi ku kishte shenja serioze për parregullsi në procesin zgjedhor të kryera nga komisioni i zgjedhjeve ditën e votimit, do të kishte dhënë mundësi që të pajtohej qëllimi i drejtë i shfuqizimit të rezultateve zgjedhore, konkretisht ruajtja e ligjshmërisë së procesit zgjedhor, me të drejtat subjektive të zgjedhësve dhe të kandidatëve në zgjedhjet parlamentare.

37. Në çështjen *Oran k. Turqisë*, bëhej fjalë për pamundësinë e zgjedhësve jo me banim aty për të votuar për kandidatët e pavarur pa parti në qendrat e votimit të ngritura nëpër pikat doganore. Votat e shprehura në ato kushte mund të jepeshin vetëm për partitë politike. Ky kufizim për ligje me faktin se ishte e pamundur që zgjedhësit e çatdhesuar të caktoheshin në një zone zgjedhore. Gjykata që e mendimit se ky kufizim duhej të vlerësohej duke marrë parasysh kufizimet e përgjithshme të pranuar ndaj ushtrimit të së drejtës së votës për të çatdhesuarit dhe, në veçanti, shqetësimin e drejtë që mund të ketë ligjvënësi për ta kufizuar ndikimin e qytetarëve me banim jashtë shtetit mbi zgjedhjet që kanë të bëjnë me pika të cilat prekin në radhë të parë personat që janë me banim brenda vendit. Kësaj duhej t'i shtojë roli i luajtur nga partitë politike, të vetmet formacione në gjendje për të ardhur në pushtet, të cilat kanë aftësinë për të ushtruar një ndikim mbi tërë regjimin e vendit të tyre. Për më tepër, ky kufizim ndiqte edhe dy qëllime të drejta të tjera: të përforcohej pluralizmi demokratik duke shmangur njëherazi një fragmentim të tepruar të votimit dhe të fuqizohej shprehja e mendimit të popullit lidhur me zgjedhjen e organit ligjvënës. Për rrjedhojë, ky kufizim i përgjigjej shqetësimin të drejtë të ligjvënësit për të siguruar stabilitetin politik të vendit dhe të qeverisë që do të ngarkohej për ta drejtuar atë në përfundim të këtyre zgjedhjeve. Pra nuk kishte pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1.

III. Aspekti pasiv: e drejta për të qenë kandidat në zgjedhje

38. Ashtu si aspekti “aktiv”, aspekti “pasiv”, e drejta për të qenë kandidat në zgjedhje, është një zbulim i jurisprudencës. Gjykata ka deklaruar në fakt se e drejta për të qenë kandidat në zgjedhje është “e pandashme nga nocioni i regjimit me të vërtetë demokratik” (*Podkolzina k. Letonisë*, § 35). Mirëpo kontrolli i ushtruar nga Gjykata lidhur me këtë aspekt të neni 3 të Protokollit nr. 1 është më pak i rreptë sesa ç’është për sa i përket së drejtës së votës; kontrolli i përpjesëtueshmërisë është më pak i thellë. Shtetet gëzojnë pra në këtë fushë një hapësirë vlerësimi më të gjerë sesa kur bëhet fjalë për aspektin “aktiv” (*Etzeberria me të tjerë k. Spanjës*, § 50).

39. Megjithatë, ndalimi i diskriminimit, i parashikuar nga neni 14 i Konventës, edhe këtu nuk zbatohet më pak. Por, në këtë kontekst, ndonëse hapësira për vlerësim që u njihet zakonisht shteteve në fushën e së drejtës për të qenë kandidat në zgjedhje është e gjerë, në qoftë se dallimi në trajtim bëhet mbi bazë race, ngjyre ose prejardhjeje etnike, nocioni i përligjes objektive dhe të arsyeshme duhet të interpretohet në mënyrë sa më të rreptë (*Sejdić e Finci k. Bosnjë-Hercegovinës* [DhM], § 44).

40. Në çështjen *Sejdić e Finci k. Bosnjë-Hercegovinës* [DhM], Gjykatës i është dashur të shqyrtojë një rregull përjashtimi sipas të cilit, për të mundur që të ishte kandidat në zgjedhjet për Dhomën e Popujve të Bosnjë-Hercegovinës, duhej të deklaroje se i përkisje njërit nga “popujt shtetformues”. Pra, kandidatët potencialë që nuk pranonin të deklaronin një përkatësi të tillë nuk mund të paraqiteshin. Gjykata ka vënë re se ky rregull përjashtimi ndiqte të paktën një qëllim globalisht të pajtueshëm me objektivat e përgjithshëm të Konventës, konkretisht atë të rivendosjes së paqes. Kur ishin vendosur dispozitat kushtetuese të kundërshtuara, në terren mbizotëronte një armëpushim shumë i brishtë. Dispozitat në fjalë synonin që t’i jepnin fund një konflikti të ashpër ku ishin shënuar ngjarje gjenocidi e spastrimi etnik. Natyra e konfliktit ishte e tillë që miratimi i “popujve shtetformues” (konkretisht boshnjakët, kroatët dhe serbët) ishte i domosdoshëm për të siguruar paqen. Kjo mund ta shpjegonte, pa qenë e thënë që ta përligjte, mungesën e përfaqësuesve të komuniteteve të tjera (veçanërisht të komuniteteve lokale të romëve dhe të çifutëve) në bisedimet për paqen si edhe merakun e negociatorëve për t’u kujdesur për një barazi efektive ndërmjet “popujve shtetformues” në shoqërinë e pasluftës. Sidoqoftë, në Bosnjë-Hercegovinë kanë ndodhur zhvillime të mëdha pozitive që prej Marrëveshjes së Dejtonit. Përveç kësaj, duke i ratifikuar Konventën dhe Protokollet e saj pa rezerva, shteti ka pranuar me vullnet të lirë që të respektojë standardet përkatëse. Prandaj, Gjykata ka dalë në konkluzionin se ruajtja e pamundësisë për paditësit, me prejardhje rome ose çifute, për të qenë kandidatë në zgjedhje nuk mbështetej në ndonjë përligje objektive dhe të arsyeshme dhe ishte kështu në kundërshtim me nenin 14 të bashkuar me nenin 3 të Protokollit nr. 1.

41. Në çështjen *Zornić k. Bosnjë-Hercegovinës*, për të njëjtat arsye, Gjykata ka dalë në konkluzionin se kishte pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 lidhur me pamundësinë e paditëses për t’u zgjedhur në Dhomën e Popujve dhe në Presidencë. Duke vënë re një vonesë të tepruar në zbatimin e vendimit *Sejdić e Finci k. Bosnjë-Hercegovinës* [DhM] dhe faktin se shkelja për të cilën ngrihej padi në këtë çështje ishte rezultat i drejtpërdrejtë i saj, Gjykata u shpreh në suazën e nenit 46 të Konventës. Ajo çmoi se, tetëmbëdhjetë vjet pas fundit të konfliktit tragjik që ka bërë kërdrinë në Bosnjë-Hercegovinë, kishte ardhur koha për të miratuar një sistem politik të aftë për t’i ofruar çdo qytetari të këtij vendi të drejtën për të qenë kandidat për Presidencën e vendit dhe për Dhomën e Popujve pa dallim mbi bazë përkatësie etnike (*Zornić k. Bosnjë-Hercegovinës*, § 43).

42. Në çështjen *Tănase k. Moldavisë* [DhM], Gjykata është shprehur rreth pikës së personave me dyshtetësi, ndonëse vetëm nën këndvështrimin e nenit 3 të Protokollit nr. 1. Ajo ka vënë re aty ekzistencën e një konsensusi se, kur lejohet shumëshetësia, zotërimi i më shumë se një shtetësie nuk duhet të jetë arsye për pazgjedhshmëri në detyrën e deputetit, edhe nëse popullsia paraqet njëfarë larmie etnike dhe numri i deputetëve me shumëshetësi rrezikon të jetë i lartë.

A. Pamundësia për të qenë kandidat dhe rendi demokratik

43. Kur është fjala për kufizime që i bëhen së drejtës për të qenë kandidat në zgjedhje, mbrojtja e rendit demokratik bën pjesë të qëllimet e pajtueshme me parimin e sundimit të ligjit dhe me objektivat e përgjithshëm të Konventës.

44. Mirëpo, për të qenë i pajtueshëm me Konventën, mospranimi i një kandidature duhet të jetë në radhë të parë i ligjshëm, domethënë, konkretisht, të jetë i parashikuar me ligj. Në çështjen *Dicle e Sadak k. Turqisë*, paditësit, deputetë të një partie politike të shpërndarë, ishin dënuar me masa të rënda burgimi se i përkisnin një organizate të paligjshme. Pas një vendimi të Gjykatës Evropiane, procesi i tyre u riçel. Megjithatë, kandidaturat e tyre në zgjedhjet legjislative u rrëzuan me arsyetimin se ata nuk e kishin vuajtur të gjithë dënimin. Në shqyrtimin e saj në këndvështrimin e nenit 6 § 2 të Konventës, Gjykata vuri në dukje se nga vendimet kombëtare dilte që, pas riçeljes së procesit, çështja duhej të gjykohej nga e para. Ajo nxori andej konkluzionin se mbajtja e dënimit fillestar në dosjen gjyqësore të paditësve dhe mospranimi për rrjedhojë i kandidaturës së tyre nuk ishin të parashikuar me ligj dhe se kishte pasur pra shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1.

45. Në çështjen *Etxeberria me të tjerë k. Spanjës*, kandidaturat e paditësve u anuluan me arsyetimin se ato kishin për qëllim që të vijonin veprimtaritë e tri partive të shpallura më parë të paligjshme dhe të shpërndara për arsye të mbështetjes prej tyre të dhunës dhe të veprimtarive të ETA-s, një organizatë terroriste. Gjykata që e mendimit se autoritetet kombëtare kishin në dispozicion elemente të shumta që jepnin mundësi për të dalë në konkluzionin se grupimet e kundërshtuara zgjedhore donin të vazhdonin veprimtaritë e partive në fjalë. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë ishte bazuar mbi elemente shtesë në programin e grupimeve të kundërshtuara dhe autoritetet i kishin marrë vendimet për anulim të kandidaturave në mënyrë të individualizuar. Përveç kësaj, pas një shqyrtimi me ballafaqim gjatë të cilit këto grupime kishin mundur t'i paraqesin vërejtjet e tyre, juridiksionet e brendshme kishin gjetur në mënyrë të padyshimtë një lidhje me partitë politike të shpallura të paligjshme. Së fundi, konteksti politik që ekzistonte në Spanjë, konkretisht prania e partive politike me karakter lëvizjeje për pavarësi në organet e qeverisjes së disa bashkësive autonome dhe veçanërisht në Vendin e Baskëve, provon se masa e kundërshtuar nuk ishte pjesë e ndonjë politike për ndalim të çdolloj shfaqjeje idesh separatiste. Për rrjedhojë, Gjykata doli në përfundimin se kufizimi i kundërshtuar ishte në përpjesëtim me qëllimin e drejtë të ndjekur.

46. Megjithatë, ndonëse është më pak i rreptë sesa kur bëhet fjalë për aspektin aktiv të nenit 3 të Protokollit nr. 1, prapëseprapë kontrolli i aspektit pasiv nga ana e Gjykatës nuk është i paqenë. Në veçanti, kontrolli i përpjesëtueshmërisë, edhe pse relativisht i lakueshëm, është real. Gjykata ka vënë re konkretisht disa shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 për arsye të shpërpjesëtimit të sanksioneve të dhëna ndaj disa të zgjedhurve pasi partitë e tyre politike janë shpërndarë për cenim të tërësisë territoriale dhe të njësisë së shtetit ose për të ruajtur karakterin laik të regjimit politik (shih paragrafët 82-84 të mëposhtëm).

47. Është me rëndësi të shënohet se çështjet që kanë të bëjnë me ndalimin e partive politike për arsye të papajtueshmërisë së programit të tyre me parimet demokratike shqyrtohen zakonisht në këndvështrimin e nenit 11 (liria e tubimit dhe e organizimit) të Konventës. Neni 3 i Protokollit nr. 1 konsiderohet atëherë vetëm si plotësues dhe që nuk ngre ndonjë pikë më vete (*Refah Partisi (Partia e Begatisë) me të tjerë k. Turqisë* [DHM]; *Linkov k. Republikës Çeke*; *Parti nacionaliste basque – Organisation régionale d'Iparralde k. Francës*).

B. Rëndësia e kontekstit historik

48. Ndonëse nisen nga një shqetësim i përbashkët – të sigurohet pavarësia e të zgjedhurve por gjithashtu edhe liria e zgjedhësve –, Gjykata e pranon që kriteret e zgjedhshmërisë ndryshojnë në varësi të faktorëve të veçantë historikë e politikë të secilit shtet. Moria e situatave të parashikuara nëpër kushtetutat dhe legjislacionet zgjedhore të shumë shteteve anëtare vërteton larminë e

zgjedhjeve të mundshme në këtë fushë. Për qëllimet e zbatimit të nenit 3 të Protokollit nr. 1, çdo ligj zgjedhor duhet të vlerësohet pra gjithmonë në dritën e evolucionit politik të vendit në fjalë (*Mathieu-Mohin e Clerfayt k. Belgjikës*, § 54; *Podkolzina k. Letonisë*, § 33; *Ždanoka k. Letonisë* [DhM], § 106).

49. Në çështjen *Ždanoka k. Letonisë* [DhM], paditësja ishte anëtare e një partie në zanafillë të një tentative për grusht shteti. Më pas, kandidatura e saj në zgjedhje nuk u pranua disa herë për arsye të veprimtarive të saj me partinë në fjalë, të vazhduara pas tentativës për grusht shteti. Gjykata çmoi se pozita e dikurshme e paditëses brenda partisë, e bashkuar me sjelljen e saj gjatë tentativës për grusht shteti, mund ta përlligite, ende sot, që ajo të mos lejohej të paraqitej në zgjedhjet legjislative. Ndonëse një kufizim i tillë nuk mund të lejohej kurrësi, për shembull, në një vend që ka një kornizë institucionesh demokratike të vendosur që prej disa dhjetëvjeçarësh a disa shekujsh, ai mund të gjykohej si i pranueshëm në Letoni, duke pasur parasysh kontekstin historiko-politik si edhe kërcënimin për rendin e ri demokratik. Sidoqoftë, Gjykata ka shtuar se Parlamenti leton duhej ta rishikonte në mënyrë të vazhdueshme kufizimin në fjalë, me qëllimin për t'i dhënë atij fund brenda në afati të shkurtër. Ky konkluzion përlligjej për më tepër në dritën e stabilitetit të përforcuar që gëzonte tani Letonia, veçanërisht për shkak të integritetit të saj të plotë e të tërësishëm në familjen evropiane. Prandaj, çdo mosveprim i organit ligjvënës leton në këtë drejtim mund ta detyronte Gjykatën që ta rishikonte konkluzionin e saj (*po aty*, §§ 132-135).

50. Më vonë, Gjykata e ka theksuar sërish rëndësinë e kalimit të kohës dhe nevojën për një rivlerësim të legjislacionit për sa u përkiste ligjeve të lustracionit. Në çështjen *Ādamsons k. Letonisë*, paditësit, ish-kryeministër, nuk i ishte pranuar kandidatura me arsyetimin se, në të kaluarën, ai paskësh qenë agjent i KGB-së. Gjykata i ripohoi konkluzionet e saj lidhur me kontekstin historik të vendit. Ajo shtoi megjithatë se, me kalimin e kohës, nuk mjaftonte më thjesht një dyshim i përgjithshëm ndaj një grupi personash dhe se autoritetet duhej të sillnin argumente dhe elemente provash shtesë për ta përlligjur masën e kundërshtuar. Ligji i zbatuar në këtë çështje vinte në shënjestër ish-agjentët e KGB-së. Mirëpo, duke pasur parasysh larminë e funksioneve të këtij organi, ky nocion ishte tepër i gjerë. Në këto rrethana, nuk mjaftonte më që vetëm të konstatohej se i interesuari i përkiste grupit të vënë në shënjestër. Meqenëse ky grup ishte përkufizuar në mënyrë tepër të përgjithshme, një kufizim i të drejtave zgjedhore të pjesëtarëve të tij duhej të kishte ndjekur një qasje të individualizuar që jepte mundësi për të marrë parasysh sjelljen e tyre reale. Nevoja për këtë individualizim bëhej gjithnjë e më e rëndësishme me kalimin e kohës. Paditësi nuk ishte akuzuar asnjëherë që kishte qenë i përzier drejtpërdrejt ose tërthorazi as në prapësitë e regjimit totalitar, as në kurrfarë veprimi që të dëshmonte për ndonjë kundërvënje apo armiqësi ndaj rivendosjes së pavarësisë së Letonisë e rendit të saj demokratik. Madje, ai ishte shpallur zyrtarisht i pazgjedhshëm vetëm fare vonë, pas dhjetë vitesh të një karriere të shquar ushtarake dhe politike në Letoninë e rimëkëmbur. Kështu, vetëm arsyet më të ngutshme mund të ishin ato që mund ta përlligjin pazgjedhshmërinë e paditësit në këto kushte. Përveç kësaj, afati dhjetëvjeçar gjatë të cilit ish-agjentëve të KGB-së mund t'u viheshin kufizimet e parashikuara nga disa tekste të tjera ligjore ishte zgjatur me dhjetë vjet shtesë, pa u dhënë arsyet për këtë as nga Parlamenti, as nga Qeveria. Gjykata doli pra në konkluzionin se kjo zgjatje kishte pasur një karakter haptazi arbitrar ndaj paditësit.

C. Organizimi i jetës politike

51. Organizimi praktik i zgjedhjeve është një fushë komplekse e cila kërkon vendosjen dhe nganjëherë ndryshimin e disa legjislacioneve të ndërlikuara. Kur asaj i kërkohet që të shprehet lidhur me to, Gjykata mban gjithmonë parasysh këtë karakter kompleks si edhe veçoritë e secilit shtet. Për pasojë, edhe këtu shteteve u lihet një hapësirë e gjerë për vlerësim.

52. Gjykata ka çmuar në veçanti se një administrim i mirë i listave zgjedhore përbën një kusht paraprak për të pasur votim të lirë e të ndershëm. Efektiviteti i së drejtës për të qenë kandidat në

zgjedhje varet pa dyshim nga ushtrimi me ndershmëri i së drejtës së votës. Keqadministrimi i një liste zgjedhore do t'i pakësonte gjasat që kandidatët të paraqiten në zgjedhje me barazi e drejtësi të plotë (*Partia e Punës e Gjeorgjisë k. Gjeorgjisë*, §§ 82-83). Në një rast ku rregullat e regjistrimit në listat zgjedhore ishin ndryshuar në mënyrë të papritur vetëm një muaj përpara votimit, Gjykata vuri në dukje se, sigurisht, sistemi i ri i regjistrimit paraqiste të meta, por ajo i kushtoi më shumë rëndësi faktit se autoritetet nuk i kishin kursyer përpjekjet e tyre për ta bërë më të ndershëm votimin e ri. Në veçanti, atyre u ishte dashur të ndreqnin, brenda një afati shumë të shkurtër dhe në një kontekst politik "pasrevolucionar", çorganizimin që karakterizonte listat zgjedhore dhe do të kishte qenë diçka e tepruar e jorealiste të pritej prej tyre që të arrinin në një zgjidhje ideale. U takonte zgjedhësve që ta verifikonin regjistrimin e tyre dhe të kërkonin korigjimin e tij nëse ishte i nevojshëm. Gjykata nxori konkluzionin se kjo gjë i përkiste hapësirës për vlerësim të shtetit (*po aty*).

1. Sigurimi i seriozitetit të kandidaturave: rregulli i depozitës së garancisë

53. Ligjet zgjedhore të një numri të caktuar shtetesh parashikojnë depozitim të një garancie nga kandidati i ardhshëm me qëllim që të shkurajohen kandidaturat joserioze. Masa të tilla i bëjnë më të përgjegjshëm personat që paraqiten në zgjedhje dhe i kufizojnë këto të fundit vetëm për kandidatët seriozë duke mos lejuar njëkohësisht një shpërdorim të fondeve publike. Ato mund të kenë pra si qëllim të drejtë garantimin e së drejtës për një përfaqësim efektiv dhe të racionalizuar (*Soukhovetski k. Ukrainës*, §§ 61-62).

54. Gjithsesi, shuma e garancisë duhet të mbetet e përpjesëtuar, në mënyrë që të ruajë një baraspeshë midis shkurajimit të kandidaturave abuzive, në njërin anë, dhe garantimit të zgjedhshmërisë së të gjithëve, në anën tjetër. Gjykata merr kështu parasysh shumën e depozitës në fjalë, shërbimet e dhëna nga shteti në suazën e fushatave zgjedhore si edhe shpenzimet e tjera të rëndësishme që shkaktohen nga organizimi i zgjedhjeve, të cilat mund të lehtësohen në saje të garancive të derdhura.

55. Nëse respektohet përpjesëtueshmëria, kërkesa e një depozite garancie nuk ka sesi të shihet si ndonjë pengesë e pakapërcyeshme administrative apo financiare për personat që dëshirojnë vërtet të paraqiten në zgjedhje, dhe aq më pak si ndonjë fre ndaj daljes së lëvizjeve politike me përfaqësi të mjaftueshme apo si ndonjë cenim i pluralizmit (*po aty*, §§ 72-73). Detyrimi për të derdhur një garanci zgjedhore dhe dispozitat që e kushtëzojnë kthimin e garancisë dhe/ose të shpenzimeve të fushatës me faktin që partia të ketë marrë një përqindje të caktuar votash synojnë të favorizojnë rryma mendimi që janë mjaftueshëm përfaqësuese dhe mund të shihen kështu si të drejta e të përpjesëtuar në vështrim të nenit 3 të Protokollit nr. 1, duke pasur parasysh hapësirën e gjerë për vlerësim që u lihet Shteteve Kontraktuese në këtë fushë (*Partia Konservatore Ruse e Sipërmarrësve me të tjerë k. Ruisë*, § 94). Kjo është e vlefshme edhe në qoftë se garancia nuk është e kthyeshme (*Soukhovetski k. Ukrainës*).

Megjithatë, kthimi ose jo i një garancie zgjedhore mund të ngrëjë disa pikëpyetje në këndvështrimin e nenit 1 të Protokollit nr. 1. Në çështjen *Partia Konservatore Ruse e Sipërmarrësve me të tjerë k. Ruisë*, Gjykata ka dalë në konkluzionin se procedura e brendshme, sipas së cilës ishte shfuqizuar e tërë lista e një partie për arsye të disa informacioneve të pasakta të dhëna nga disa kandidatë që figuronin aty, e kishte shkelur parimin e sigurisë juridike. Mirëpo partia paditëse e kishte derdhur tashmë garancinë zgjedhore që duhej të paguante. Duke pasur parasysh konkluzionin e saj në këndvështrimin e nenit 3 të Protokollit nr. 1, Gjykata qe e mendimit se mospranimi për ta kthyer këtë shumë përbënte shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1.

2. Shmangia e një copëzimi të tepruar të peizazhit politik

56. Kushtet lidhur me numrin e firmave të kërkuara për paraqitjen e një liste zgjedhore nuk përbëjnë pengesë për shprehjen e mendimit të popullit rreth zgjedhjes së përfaqësuesve të tij (*Asensio Serqueda k. Spanjës*, vendim i Komisionit; *Federación Nacionalista Canaria k. Spanjës* (vend.

pran.); *Brito da Silva Guerra e Sousa Magno k. Portugalisë* (vend. pran.); *Mihaela Mihai Neagu k. Rumanisë* (vend. pran.), § 31).

57. Megjithatë, masa të tilla duhet të ndjekin një qëllim të drejtë si ai i një përzgjedhjeje të arsyeshme ndërmjet kandidatëve, me qëllim për të siguruar karakterin e tyre përfaqësues dhe për të shmangur kandidatura eventualisht të papërshtatshme, si edhe të jenë të përpjesëtuara me të. Kështu, një prag prej 100 000 firmash, i cili përfaqëson 0,55% të të gjithë qytetarëve të regjistruar në listat zgjedhore, është gjykuar si në përputhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 (*po aty*).

58. Po ashtu, Gjykata ka çmuar se kërkesa për t'i shoqëruar firmat me vërtetimet e regjistrimit të firmëtarëve në regjistrat zgjedhorë ndiqte qëllimin e drejtë për t'u siguruar që firmëtarët e kanë zotësinë zgjedhore dhe që secili prej tyre mbështet vetëm një kandidaturë. Pra, nuk ishte diçka e shpërpjesëtuar që të mos pranohej një kandidaturë e cila nuk i përmbushte këto kritere formale (*Brito da Silva Guerra e Sousa Magno k. Portugalisë* (vend. pran.)).

59. Sidoqoftë, kërkesa e një numri minimal firmash dhe verifikimi i tyre duhet të bëhen sipas rregullave të shtetit ligjor dhe të mbrojnë paprekshmërinë e zgjedhjeve. Në çështjen *Tahirov k. Azerbajxhanit*, garancitë e ofruara nga Komisioni Zgjedhor që e kishte rrëzuar kandidaturën e paditësit nuk ishin të mjaftueshme, sidomos për sa i përkiste mënyrës së caktimit të ekspertëve që shpreheshin rreth vlefshmërisë së firmave. Përveç kësaj, paditësi nuk kishte mundur të ishte i pranishëm në mbledhjet e Komisionit, as të paraqiste aty argumentet e tij nga të cilat asnjë nuk ishte bërë objekt për shqyrtim. Rrëzimi i kandidaturës së paditësit për arsye të pavlefshmërisë së pretenduar të firmave që ai kishte paraqitur ishte pra arbitrar. Për më tepër, duke u mbështetur te një raport i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Gjykata vuri në dukje karakterin sistematik të këtyre të metave dhe numrin e kandidaturave të rrëzuara arbitrarisht për pavlefshmeri firmash. Ajo doli andej në konkluzionin se deklarata e njëanshme e Qeverisë nuk do të mjaftonte për të garantuar respektimin e të drejtave të njeriut, e hodhi poshtë atë dhe vijoi me shqyrtimin e saj në themel.

60. Kritere të tilla pragu janë pranuar gjithashtu nga Gjykata lidhur me ndarjen e vendeve në varësi të rezultatit të zgjedhjeve. Çdo sistem zgjedhor kërkon t'u japë përgjigje disa objektivave nganjëherë pak të pajtueshëm midis tyre: në njërin anë, të pasqyrohen në mënyrë përafërsisht besnike mendimet e popullit dhe, në anën tjetër, të kanalizohen rrymat e mendimit për të favorizuar trajtësimin e një vullneti politik me koherencë e qartësi të mjaftueshme. Për pasojë, neni 3 i Protokollit nr. 1 nuk nënkupton që të gjitha votat duhet të kenë një peshë të barabartë për sa i përket rezultatit, as çdo kandidat gjasa të barabarta për të fituar dhe asnjë sistem nuk e shmang dot dukurinë "votave të shkuara dëm" (*Partija "Janie Demokratë" e Partija "Mūsu Zeme" k. Letonisë* (vend. pran.)).

61. Efektet e një pragu zgjedhor mund të ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin dhe sistemet e ndryshme mund të synojnë qëllime politike divergjente, madje antagoniste. Një sistem mund të privilegjojë përfaqësimin e drejtë të partive në parlament, kurse një tjetër mund të synojë të shmangë fragmentimin e përfaqësimit në parti të vogla me qëllim për t'i dhënë një shumicë absolute deputetësh formacionit të ngarkuar me krijimin e qeverisë. Gjykata ka qenë e mendimit se asnjë nga këto qëllime nuk është i paarsyeshëm në vetvete. Përveç kësaj, roli që luajnë pragjet ndryshon sidomos në varësi të lartësisë së tyre dhe të konfigurimit të partive ekzistuese në secilin vend. Një prag i ulët mënjanon vetëm formacionet shumë të vogla, çka e bën më të vështirë krijimin e shumicave të qëndrueshme, ndërkohë që në rast fragmentimi të madh të peizazhit politik, një prag i lartë bën që të përjashtohet nga përfaqësimi një pjesë e rëndësishme e votave. Kjo mori situatash tregon larminë e zgjedhjeve të mundshme në këtë fushë. Për rrjedhojë, Gjykata e vlerëson pragu për të cilin bëhet fjalë duke marrë parasysh sistemin zgjedhor ku ai përfshihet (*Yumak e Sadak k. Turqisë* [DhM], §§ 131-132).

62. Për sa i përket, për shembull, kërkesës së dy kushteve alternative – për të marrë ose të paktën 30% të votave të vlefshme të dhëna në një zonë ishullore individuale, ose të paktën 6% të votave të

vlefshme të dhëna në tërë bashkësinë autonome –, Gjykata ka çmuar se një sistem i tillë, duke mos përbërë aspak pengesë për kandidaturat zgjedhore, u jep njëfarë mbrojtjeje formacioneve të vogla politike (*Federación Nacionalista Canaria k. Spanjës* (vend. pran.)). Në të njëjtën mënyrë, Gjykata ka dalë në konkluzionin se pragu prej 5% të votave që duhet të kapërcejë një listë kandidatësh në shkallë kombëtare për t'u quajtur e zgjedhur dhe për të marrë pjesë në ndarjen e vendeve është në përputhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1, meqenëse ai favorizon ato rryma mendimi që janë mjaftueshëm përfaqësuese dhe jep mundësi për ta shmangur një fragmentim të tepruar të Parlamentit (*Partija "Jaunie Demokrāti" e Partija "Mūsu Zeme" k. Letonisë* (vend. pran.)).

63. Në çështjen *Strack e Richter k. Gjermanisë* (vend. pran.), Gjykata ka rikujtuar jurisprudencën e saj rreth pragjeve zgjedhore në vështrim të Konventës (§ 33). Përveç kësaj, ajo është shprehur për herë të parë rreth pikës së pragjeve zgjedhore në aspektin aktiv të nenit 3 të Protokollit nr. 1, meqenëse disa zgjedhës i ishin drejtuar asaj në këtë çështje. Në fakt, paditësit ankoheshin për prahun e detyrueshëm prej 5% të votave të shprehura në rrafsh kombëtar në mënyrë që një parti politike të mund pretendonte për një nga vendet e caktuara për Gjermaninë në Parlamentin Evropian. Më 2011, Gjykata Kushtetuese gjermane e kishte shpallur këtë dispozitë ligjore në kundërshtim me Ligjin Themelor, por pa i bërë të pavlefshme rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2009. Gjykata Evropiane e ka rrëzuar kërkesëpadinë duke qenë e mendimit se ajo ndërhyrje ishte e përpjesëtuar me qëllimin e drejtë të ndjekur (ruajtjen e stabilitetit parlamentar) në vështrim të hapësirës së gjerë për vlerësim që u lihet shteteve në këtë fushë. Ajo ka vënë në dukje se Bashkimi Evropian ua lejonte shprehimisht shteteve anëtare që të caktonin pragje zgjedhore të cilat shkonin deri në 5% të votave të shprehura dhe se këtë kompetencë e përdornin një numër i konsiderueshëm shtetesh anëtare.

64. Çështja *Partei Die Friesen k. Gjermanisë* kishte të bënte me prahun prej 5% të votave të shprehura të vendosur nga *Land*-i i Saksonisë së Poshtme, për të fituar vende në Parlament. Paditësja, një parti politike që përfaqësonte interesat e një grupi pakice në këtë *Land*, pretendonte se zbatimi i këtij pragu përbënte shkelje të së drejtës së saj për të marrë pjesë në zgjedhje pa u diskriminuar (neni 14 i Konventës i bashkuar me nenin 3 të Protokollit nr. 1) dhe kishte kërkuar që të përjashtohet prej tij. Bëhej pra fjalë për shtrirjen e detyrimeve që rëndojnë mbi shtetet anëtare për sa i përket mbrojtjes së pakicave në kontekstin zgjedhor. Gjykata ka qenë e mendimit se, edhe e interpretuar në dritën e Konventës-Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të vitit 1998 – e cila ka theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së pakicave kombëtare në çështjet publike –, Konventa nuk urdhëronte që partitë që përfaqësojnë një pakicë të përfitojnë një trajtim më të favorshëm. Ajo doli në konkluzionin se nuk kishte pasur shkelje të Konventës.

65. Por, nga ana tjetër, në çështjen *Yumak e Sadak k. Turqisë* [DhM], ajo ka qenë e mendimit se, në përgjithësi, një prag zgjedhor prej 10% dukej i tepruar dhe i ka përqaftuar mendimet e organeve të Këshillit të Evropës të cilat rekomandonin uljen e tij. Ky prag i detyronte partitë politike që të përdornin dredhi të cilat nuk jepnin ndihmesë për transparencën e procesit zgjedhor. Megjithatë, duke pasur parasysh kontekstin politik karakteristik të zgjedhjeve në fjalë, të shoqëruar me elemente korrigjuese e garanci të tjera – si mundësia për të krijuar një koalicion zgjedhor me formacione të tjera politike ose roli i Gjykatës Kushtetuese – çka i ka kufizuar efektet e tij në praktikë, Gjykata nuk ishte e bindur që pragu i kritikuar prej 10% të kishte pasur si pasojë pengimin në thelb të të drejtave të garantuara nga neni 3 i Protokollit nr. 1.

66. Së fundi, një ndryshim i menjëhershëm dhe i paparashikueshëm i rregullave të përlogaritjes së votave rrezikon ta shkelë nenin 3 të Protokollit nr. 1. Në lidhje me disa deputetë të zgjedhur por të privuar nga vendet e tyre si pasojë e një shmangieje të paparashikueshme të Gjykatës së Lartë të Posaçme prej jurisprudencës së saj të vazhdueshme për sa i përkiste përlogaritjes së herësit zgjedhor, Gjykata ka dalë kështu në konkluzionin se kishte pasur shkelje të kësaj dispozite. Ajo ka marrë kryesisht parasysh që ky ndryshim jurisprudence, i bërë pas zgjedhjeve, e kishte ndryshuar kuptimin dhe peshën që u jepen fletëve të votimit të hedhura në kuti pa u plotësuar dhe se, për pasojë, ai kishte qenë i tillë që e kishte shtrembëruar vullnetin e shprehur nga zgjedhësit. Ai kishte

krijuar për më tepër një pabarazi në mënyrën e zgjedhjes së deputetëve (*Paschalidis, Koutmeridis e Zaharakis k. Greqisë*).

D. Qëllimet e tjera të drejta

67. Duke mos qenë të kufizuar nga një listë shteruese ashtu si në suazën e neneve 8 deri 11 të Konventës, ka edhe disa qëllime të tjera të drejta që mund të pranohen prej Gjykatës për të përligjur një pengesë ndaj së drejtës për t'u paraqitur në zgjedhje.

68. Kështu, Gjykata ka bërë një dallim midis besnikërisë ndaj shtetit dhe besnikërisë ndaj qeverisë. Në qoftë se nevoja për t'u kujdesur për besnikërinë ndaj shtetit mund të përbëjë një qëllim të drejtë i cili i përligj disa kufizime të të drejtave zgjedhore, kjo nuk vlen për besnikërinë ndaj qeverisë (*Tănase k. Moldavisë* [DhM], § 166). Po ashtu, detyrimi për të pasur një njohuri të mjaftueshme të gjuhës zyrtare mund të ndjekë një qëllim të drejtë (*Podkolzina k. Letonisë*). Gjykata ka nxjerrë gjithashtu konkluzionin se detyrimi i kandidatëve në zgjedhje legjislative për të paraqitur të dhëna të përpikta rreth punësimit të tyre ose anëtarësisë së tyre në një parti politike u jep mundësi zgjedhësve për të bërë një zgjedhje të mirinformuar në varësi të situatës profesionale dhe politike të kandidatit dhe përbën pra një qëllim të drejtë (*Krasnov e Skouratov k. Ruisisë*). Por, nga ana tjetër, një pazgjedhshmëri e shpallur për arsye të një të mete formale të një dokumenti të paraqitur nga një kandidat nuk është e përpjesëtuar me qëllimin e drejtë të ndjekur (*po aty*, §§ 65-66).

69. Gjykata ka dalë gjithashtu në konkluzionin për papranueshmëri të një kërkesëpadie ku denoncohej detyrimi i një partie politike protestante shumë tradicionale për t'i hapur edhe për gratë listat e saj të kandidatëve për zgjedhje. Ajo parashtroi atëherë se përparimi drejt barazisë gjinore në gjirin e shteteve anëtare nuk e lejonte shtetin që ta pranonte idenë se burri luan një rol parësor e gruaja një rol dytësor (*Staatkundig Gereformeerde Partij k. Vendeve të Ulëta* (vend. pran.)).

70. Përveç kësaj, në çështjen *Melnitchenko k. Ukrainës*, paditësit, refugjat në Shtetet e Bashkuara, nuk i ishte pranuar regjistrimi i kandidaturës së tij me arsyetimin se paskësh paraqitur të dhëna të rreme lidhur me vendbanimin e tij. Në fakt, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ai kishte paraqitur të dhënat që figuronin në pasaportën e tij të brendshme, të cilën e zotëronte ende dhe ku tregohesh se ai ishte me banim në Ukrainë. Gjykata e pohoi se mund të pranohet që për regjistrimin e kandidaturave të vendosej një kusht vendbanimi. Megjithatë, ajo vuri në dukje se paditësi e kishte respektuar të drejtën e brendshme e cila nuk kërkonte ndonjë vendbanim të vazhdueshëm brenda territorit. Për më tepër, ai ndodhej në një situatë në të cilën nuk kishte rrugë tjetër përveçse të qëndronte në Ukrainë ku i kërcënohej tërësia fizike, çka do ta kishte bërë të pamundur ushtrimin e të drejtave të tij politike, ose të largohej nga ai vend e të mos mund ta paraqiste më kandidaturën e tij në zgjedhje. Gjykata doli pra në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1.

71. Së fundi, në çështjen *Antonenko k. Ruisisë* (vend. pran.), një gjykatë ia kishte ndaluar paditësit që të paraqitej në zgjedhjet legjislative një ditë para votimit me arsyetimin se kishte pasur parregullsi financiare dhe se fushata zgjedhore kishte qenë e pandershme. Paditësi nuk ankohej për vetë anulimin e kandidaturës së tij, por që ky kishte ndodhur shumë pak kohë para çeljes së qendrave të votimit. Gjykata qe e mendimit se ky afat ishte në përputhje me të drejtën kombëtare dhe nuk ndikonte mbi ndonjë apelim eventual, ngaqë asnjë apelim nuk ishte i mundshëm kundër vendimit.

72. Gjykata ka pranuar gjithashtu në mënyrë të përsëritur se disa kandidatë potencialë mund të mënjanohej për arsye të funksioneve që kanë pasur. Në çështjen *Gitonas me të tjerë k. Greqisë*, legjislacioni i pengonte disa kategori titullarësh funksionesh publike – mes të cilëve funksionarët publikë me pagesë dhe nëpunësit e personave juridikë shtetërorë dhe të ndërmarrjeve shtetërore – që të paraqiteshin në zgjedhje e të zgjidheshin në cilëndo zonë ku ata kishin ushtruar funksionet e tyre për më shumë se tre muaj gjatë tre viteve të fundit para zgjedhjeve; për më tepër, kjo pazgjedhshmëri nuk mund të shuhej përmes dorëheqjes paraprake të të interesuarit, siç parashikohej për disa kategori të tjera nëpunësish publikë. Gjykata çmoi se kjo masë synonte një

qëllim të dyfishtë: të siguronte barazinë e mjeteve të ndikimit midis kandidatëve me prirje të ndryshme politike dhe ta ruante elektoratin prej trysnive të titullarëve të funksioneve publike. Vitin pasues, ajo përsëriti se kufizimet ndaj pjesëmarrjes së funksionarëve të lartë të administratës vendore në disa trajta veprimtare politike ndiqnin qëllimin e drejtë të mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve – anëtarë të kuvendeve vendore dhe zgjedhës – për një regjim politik vërtet demokratik në rrafshin vendor. Fakti që këto masa zbatoheshin vetëm për aq kohë sa personat në fjalë ishin në detyra të cilat u nënshtroheshin disa kufizimeve në rrafshin politik jepte mundësi për ta siguruar përpjesëtueshmërinë e tyre (*Ahmed me të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*). Në çështjen *Brike k. Letonisë*, Gjykata shtoi se, nëse pazgjedhshmëria e nëpunësve civilë përbënte një përgjigje të përpjesëtuar me kërkesën për pavarësi të shërbimit civil, njëlloj qëndronte puna *a fortiori* edhe lidhur me pazgjedhshmërinë e gjyqtarëve, e cila ka si qëllim që t'u garantojë shtetasve të drejtat e mbrojtura nga neni 6 i Konventës. Ajo doli pra në përfundimin se nuk kishte pasur cenim të vetë thelbit të të drejtave të garantuara, përderisa gjyqtarja e kishte pasur mundësinë të jepte dorëheqje nga detyra e saj për t'u paraqitur në zgjedhje.

73. Çështja *Dupré k. Francës* (vend. pran.), kishte të bënte me zgjedhjen e dy përfaqësuesve francezë shtesë në Parlamentin Evropian më 2011, domethënë në mes të legjislaturës, si pasojë e hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës. Mes tri mundësive ekzistuese, qeveria franceze kishte zgjedhur që deputetët e rinj evropianë të emëroheshin nga Asambleja Kombëtare dhe nga gjiri i deputetëve të saj, çka e kishte penguar paditësin të ishte kandidat. Gjykata e pranoi që mënyra e emërimit e zgjedhur ashtu i përgjigjej një qëllimi të drejtë, duke pasur parasysh rrezikun për pjesëmarrje të ulët, për kosto të lartë për vetëm dy vende, si edhe anën e ndërlikuar organizative (§ 25). Për arsye të ndikimit të kufizuar të kësaj mase, Gjykata çmoi se ajo nuk ishte e shpërpjesëtuar me qëllimin e ndjekur.

74. Megjithatë, kufizimet ndaj së drejtës për të qenë kandidat në zgjedhje, edhe nëse ato ndjekin një qëllim të drejtë, nuk duhet të kenë si rezultat që ta bëjnë këtë të drejtë joefektive, qoftë ngaqë kushtet janë vendosur tepër vonë a tepër papritur, qoftë ngaqë ato nuk janë aq të qarta. Në çështjen *Lykourazos k. Greqisë*, një tekst që vendoste një papajtueshmëri profesionale të deputetëve u zbatua menjëherë në legjislaturën në vijim dhe deputetëve iu hoq mandati megjithëse ky kusht i ri nuk ekzistonte në momentin e zgjedhjes së tyre. Mirëpo zbatimi i kësaj papajtueshmërie absolute nuk përlligjej me asnjë arsye të ngutshme. Për herë të parë, Gjykata iu referua parimit të shpresës së arsyeshme dhe doli kështu në konkluzionin se kishte pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1. Ajo e zbatoi përsëri këtë parim në çështjen *Ekoglasnost k. Bullgarisë*. Sado që asnjë nga tre kushtet e reja të futura në legjislacionin zgjedhor nuk përbënte në vetvete ndonjë problem, për arsye të futjes së tyre me vonesë, partia paditëse pati vetëm një muaj kohë për t'i përmbushur ato. Mirëpo Gjykata ka qenë e mendimit se kushtet për pjesëmarrje në zgjedhje që u vihen formacioneve politike bëjnë pjesë të rregullat zgjedhore themelore. Prandaj, ato duhet të kishin të njëjtën qëndrueshmëri në kohë si edhe elementet e tjera themelore të sistemit zgjedhor. Gjykata ka gjykuar gjithashtu se dispozitat mbi bazën e të cilave një ish-pjesëtar i të klerit nuk i ishte pranuar kandidatura ishin tepër të mjegullta e për pasojë të paparashikueshme. Për rrjedhojë, ato u jepnin instancave zgjedhore një hapësirë të tepruar vlerësimi dhe linin tepër vend për arbitraritet në zbatimin e këtij kufizimi (*Seyidzade k. Azerbajxhanit*).

E. Nga fushata zgjedhore...

75. Në mënyrë që të drejtat e garantuara nga neni 3 i Protokollit nr. 1 të jenë efektive, mbrojtja e tyre nuk mund të mbetet vetëm brenda caqeve të vetë aktit të kandidaturës. Në fushën e tij të zbatimit hyn pra gjithashtu edhe fushata zgjedhore.

76. Në disa çështje që kishin të bënin me nenin 10 të Konventës, Gjykata kishte theksuar tashmë ndërvarësinë midis së drejtës për zgjedhje të lira dhe lirisë së shprehjes. Ajo vinte re aty se këto të drejta, sidomos liria e debatit politik, përbëjnë bazën e çdo regjimi demokratik. Të dyja të drejtat

janë të ndërvarura dhe përforcojnë njëra-tjetrën: për shembull, liria e shprehjes është një nga “kushtet që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit rreth zgjedhjes së organit ligjvënës”. Prandaj është veçanërisht e rëndësishme që, në periudhë parazgjedhore, të lejohen të qarkullojnë lirisht mendimet dhe informacionet e çdo kategorie (*Bowman k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 42).

77. Për arsye të kësaj ndërvarësie, shumë çështje që kanë të bëjnë me fushatat zgjedhore shqyrtohen në këndvështrimin e nenit 10 të Konventës. Gjykata ka dalë për shembull në konkluzionin se kishte shkelje të nenit 10 për shkak të vënies së një gjobe ndaj një televizioni ngaqë kishte transmetuar një reklamë të një partie të vogël politike, në kundërshtim me legjislacionin që ndalonte çdolloj reklame politike televizive (*TV Vest AS & Rogaland Pensjonistparti k. Norvegjisë*). Përkundrazi, ajo nuk ka vënë re ndonjë problem në vështrim të nenit 10 në rastin e një paralajmërimi që një komision zgjedhor i kishte drejtuar një politikaneje ngaqë e kishte quajtur kundërshtaren e saj “vjedhëse”, në mungesë të saj, në një emision televiziv të transmetuar drejtpërdrejt gjatë periudhës zgjedhore (*Vitrenko me të tjerë k. Ukrainës*).

78. Gjithsesi, disa çështje që kanë të bëjnë veçanërisht me ndarjen e kohës së transmetimit gjatë periudhës zgjedhore mund të paraqesin vështirësi në këndvështrimin e nenit 3 të Protokollit nr. 1. Në një çështje lidhur me barazinë e kohës së transmetimit që u jepet kandidatëve të ndryshëm, Gjykata ka pohuar se, ndonëse neni 3 i Protokollit nr. 1 sanksionon parimin e trajtimit të barabartë të të gjithë shtetasve në ushtrimin e të drejtave të tyre zgjedhore, ai nuk garanton, si të tillë, asnjë të drejtë që një partie politike t’i jepet një kohë transmetimi në radio ose në televizion në periudhë parazgjedhore. Sidoqoftë, një problem mund të lindë vërtet në disa rrethana të jashtëzakonshme, për shembull në qoftë se, në periudhë zgjedhesh, një partie politike i refuzohet çdolloj emisioni ndërkohë që partive të tjera u jepet kohë transmetimi (*Partija «Jaunie Demokrāti» e Partija «Mūsu Zeme» k. Letonisë* (vend. pran.)).

79. Në çështjen *Partia Komuniste e Ruisë me të tjerë k. Ruisë*, Gjykata mori në shqyrtim pikën nëse shteti kishte ndonjë detyrim pozitiv në bazë të nenit 3 të Protokollit nr. 1 për t’u siguruar që mbulimi nga mediet e kontrolluara ishte objektiv dhe në pajtim me frymën e “zgjedhjeve të lira”, edhe në mungesë provash të drejtpërdrejta për ndonjë manipulim të qëllimshëm. Ajo gjykoi se sistemi i ankimeve në fushën zgjedhore që ekzistonte në çështjen në fjalë ishte i mjaftueshëm për të përmbushur atë detyrim pozitiv me natyrë procedurale që i takon shtetit. Për sa i përket aspektit material të detyrimit dhe pretendimit se shteti qenka dashur të kujdesej për asnjësinë e medieve audiovizive, ajo çmoi se ishim marrë disa masa për t’u garantuar njëfarë dukshmërie në televizion partive dhe kandidatëve të opozitës e për të siguruar pavarësinë editoriale dhe asnjësinë e medieve. Sigurisht, mbase këto masa nuk kishin siguruar një barazi faktike, por ajo nuk e gjykoi si të provuar që shteti nuk i kishte përmbushur detyrimet e tij pozitive në këtë drejtim deri në atë pikë sa ta kishte shkelur nenin 3 të Protokollit nr. 1.

80. Në çështjen *Oran k. Turqisë*, paditësi ankohej se, si kandidat i pavarur, ai nuk mund të përfitonte nga propaganda zgjedhore në Radiotelevizionin e Turqisë, i cili transmetonte në të gjithë territorin kombëtar, ndryshe nga partitë politike. Gjykata qe e mendimit se, në dallim nga partitë politike, paditësi, si kandidat i pavarur, kishte të drejtë t’i drejtohej vetëm zonës zgjedhore në të cilën ai paraqitej. Përveç kësaj, ai nuk ishte penguar të përdorte të gjitha mjetet e tjera të disponueshme të propagandës të cilat ishin të arritshme për çdo kandidat të pavarur e pa parti në kohën e ngjarjeve. Gjykata doli kështu në konkluzionin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1.

81. Së fundi, në çështjen *Uspaskich k. Lituanisë*, paditësi, një politikan, ankohej se mbajtja e tij në arrest shtëpie (për arsye të një hetimi penal për korrupsion politik) e kishte penguar atë të merrte pjesë në zgjedhje legjislative në mënyrë të barabartë me kandidatët e tjerë. Për të dalë në konkluzionin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1, Gjykata qe në veçanti e mendimit se ai mund ta zhvillonte fushatën e tij zgjedhore nga banesa e vet po të donte. Duke qenë se ai ishte asokohe një personalitet i njohur politik dhe anëtarë të partisë së tij kishin marrë pjesë personalisht në takime me zgjedhësit, mbajtja në arrest shtëpie nuk e kishte kufizuar të drejtën e

paditësit për të marrë pjesë në zgjedhje deri në atë pikë sa të ishte prekur rezultati zgjedhor përfundimtar. Përveç kësaj, e drejta e brendshme parashikonte një sistem shqyrtimi të ankimeve dhe të apeliemeve individuale në fushën zgjedhore, nga i cili paditësi kishte përfituar plotësisht.

F. ... te ushtrimi i mandatit

82. Që në vitin 1984, Komisioni ka pohuar se nuk mjafton që një individ të ketë të drejtën për të qenë kandidat, por ai duhet të ketë gjithashtu edhe të drejtën për të zënë një vend në cilësinë e anëtarit pasi të jetë zgjedhur. Përndryshe, e drejta për të qenë kandidat në zgjedhje do ta humbte kuptimin e saj (*M. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Komisionit). Po në të njëjtën çështje, ai ka çmuar megjithatë se pamundësia për të zgjedhurin për të zënë vendin e tij me arsyetimin se ai është tashmë anëtar i një organi tjetër ligjvënës të huaj është një kufizim i pajtueshëm me nenin 3 të Protokollit nr. 1.

83. Në tri çështje kundër Turqisë, Gjykata ka pasur rastin që të shqyrtojë pasojat që u kanë ardhur të zgjedhurve nga shpërndarja e partive të cilave ata u përkisnin. Në çështjen *Sadak me të tjerë k. Turqisë* (nr. 2), një parti politike u shpërnda për cenim të tërësisë territoriale dhe të njësisë së shtetit. Deputetëve të zgjedhur nën emrin e saj iu hoq automatikisht mandati i tyre parlamentar. Gjykata çmoi se ndërhyrjet në lirinë e shprehjes së një parlamentar të opozitës kërkonin një kontroll nga më të rreptët. Mirëpo heqja e mandatit parlamentar të paditësve ishte bërë automatikisht dhe në mënyrë të pavarur nga veprimtaritë e tyre politike të kryera personalisht. Bëhej fjalë pra për një masë me ashpërsi të skajshme dhe në shpërpjesëtim me çdolloj qëllimi të drejtë të sjellë si argument.

84. Në çështjen *Kavakçı k. Turqisë*, të drejtave politike të paditëses u ishin bërë disa kufizime të përkohshme për arsye të shpërndarjes përfundimtare të partisë së cilës ajo i përkiste. Gjykata ka qenë e mendimit se këto masa kishin si qëllim që të ruanin karakterin laik të regjimit politik turk dhe se, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij parimi për regjimin demokratik në Turqi, kjo masë synonte qëllimet e drejta të mbrojtjes së rendit dhe të mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Mirëpo, për sa i përket përpjesëtueshmërisë së sanksionit, dispozitat kushtetuese që ishin asokohe në fuqi lidhur me shpërndarjen e një partie politike kishin rreze veprimi shumë të gjerë. Të gjitha veprimet e fjalët e anëtarëve mund t'i viheshin në ngarkim partisë, për ta quajtur këtë të fundit si një qendër veprimtarish antikushtetuese dhe për të vendosur shpërndarjen e saj. Nuk parashikohej asnjë dallim midis shkallëve të ndryshme të përzierjes së anëtarëve në veprimtaritë objekt konflikti. Përveç kësaj, disa anëtarë të partisë, konkretisht kryetari dhe nënkryetari, të cilët ndodheshin në një situatë të krahueshme me atë të paditëses, nuk ishin sanksionuar. Për rrjedhojë, Gjykata doli në konkluzionin se sanksioni nuk ishte i përpjesëtuar dhe se kishte pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1.

85. Në një çështje tjetër që kishte të bënte me heqjen e mandatit të një deputeti të së njëjtës parti, Gjykata doli përsëri në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1, por mbajti shënim me interes miratimin e një amendamenti kushtetues që e forconte statusin e parlamentarëve dhe që mbase do të kishte si efekt që ta bënte më pak të shpeshtë heqjen e një mandati. (*Sobaci k. Turqisë*).

86. Në çështjen *Lykourazos k. Greqisë*, Gjykata pati dalë në konkluzionin se papajtueshmëria e re profesionale e zbatueshme ndaj deputetëve nuk ishte njoftuar para zgjedhjeve dhe i kishte befasuar si paditësin ashtu edhe zgjedhësit gjatë mandatit. Ajo çmoi se, duke e vlerësuar zgjedhjen e paditësit në këndvështrimin e nenit të ri të Kushtetutës, të hyrë në fuqi më 2003, pa marrë parasysh faktin se kjo zgjedhje ishte zhvilluar më parë në ligjshmëri të plotë, gjyqtari i brendshëm ia kishte hequr të interesuarit funksionet e tij parlamentare dhe i kishte lënë zgjedhësit e tij pa kandidatin që ata kishin zgjedhur në mënyrë të lirë e demokratike për t'i përfaqësuar për katër vjet, duke shpërfillur parimin e shpresës së arsyeshme. Po ashtu, në çështjen *Paschalidis, Koutmeridis e Zaharakis k. Greqisë*, Gjykata pati gjykuar se një ndryshim i paparashikueshëm jurisprudence i bërë pas zgjedhjeve, lidhur

me përlllogaritjen e herësit zgjedhor, i cili kishte pasur si pasojë heqjen e mandatit të disa deputetëve, kishte përbërë shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1.

87. Çështja *Paunović e Milivojević k. Serbisë* ka qenë për Gjykatën rasti për t'u shprehur rreth praktikës së partive politike që priren të përdorin letra të paplotësuara dorëheqjeje të nënshkuara paraprakisht nga anëtarët e tyre të zgjedhur në Parlament; partia ka kështu mundësi t'i japë fund mandatit të anëtarëve të saj në çdo moment dhe me pahir. Gjykata vuri në dukje në fillim se, ndonëse letra e dorëheqjes dorëzohet nga partia, është Parlamenti ai që i jep fund mandatit. Është shteti pra ai që ia heq deputetit mandatin e tij duke pranuar letrën e sipërpërmendur. Kërkesa e deputetit të cilit i ishte hequr mandati ishte pra e pranueshme *ratione personae*. Gjykata vuri në dukje pastaj se kjo praktikë objekt konflikti ishte në kundërshtim me të drejtën e brendshme e cila parashikon që dorëheqja të paraqitet personalisht nga deputeti i interesuar. Gjykata doli pra në konkluzionin se kishte pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1. Kurse çështja *Occhetto k. Italisë* (vend. pran.) kishte të bënte me heqjen dorë në mënyrë të vullnetshme nga një mandat në Parlamentin Evropian. Pasi kishte nënshkruar një akt heqjeje dorë nga një vend në Parlament, rezultat i një marrëveshjeje me bashkëthemeluesin e lëvizjes politike së cilës i përkiste, paditësi ndryshoi qëndrim. Mirëpo kandidati pasues në listë e kishte kërkuar tashmë mandatin në fjalë. Gjykata pohoi se, pas zgjedhjeve, një kandidat mund ta fitonte të drejtën për të zënë një vend në një organ ligjvënës, por nuk ishte i detyruar ta bënte këtë. Në fakt, çdo kandidat mund të heqë dorë, për arsye politike ose personale, nga mandati që ka marrë, dhe vendimi për të mbajtur shënim një heqje dorë të tillë nuk mund të quhet se është në kundërshtim me parimin e votimit të përgjithshëm. Ajo shtoi se refuzimi për ta pranuar revokimin e heqjes dorë nga paditësi ndiqte qëllimet e drejta të garancisë së sigurisë juridike në suazën e procesit zgjedhor si edhe të mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, konkretisht të personit që ishte shpallur i zgjedhur në vendin që mund të kishte qenë i zënë prej të interesuarit. Në këtë çështje, vullneti i paditësit ishte shprehur me shkrim e me fjalë jo të dykuptimta dhe ai kishte saktësuar se heqja dorë nga ana e tij ishte e formës së prerë. Së fundi, procedura e brendshme – në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian – i kishte dhënë atij mundësi për t'i paraqitur ato argumente që ai i çmonte të dobishme për mbrojtjen e tij. Gjykata doli pra në konkluzionin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1.

IV. Mosmarrëveshjet zgjedhore

88. Çështjet që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje lidhur me zgjedhjet kanë qenë të shumta. Mirëpo ky rast nuk mund të shqyrtohet në këndvështrimin e nenit 6 të Konventës, të cilin Gjykata e ka gjykuar të pazbatueshëm. Ajo ka dalë, për shembull, në përfundimin se e drejta për të qenë kandidat në zgjedhje për Asamblenë Kombëtare franceze dhe për ta mbajtur mandatin e fituar është me karakter politik dhe jo “civil”, kështu që mosmarrëveshjet lidhur me organizimin e ushtrimit të kësaj të drejte dalin jashtë fushës së zbatimit të nenit 6 § 1 (*Pierre-Bloch k. Francës*, § 50). Neni 6 nuk hyn në veprim as në pjesën e tij penale për sa u përket sanksioneve në lidhje me mosrespektimin e rregullave të zgjedhjeve (*po aty*, § 61). Në çështjen *Geraguyn Khorhurd Patgamavorakan Akumb k. Armenisë*, OJQ-ja paditëse kishte qenë vëzhguese në zgjedhjet legislative. Pas kësaj pati mosmarrëveshje lidhur me mosparaqitjen e dokumenteve të ndryshme. Gjykata që e mendimit se rezultati përfundimtar i procedurës në fjalë nuk ishte vendimtar për të drejtat civile të OJQ-së dhe se kjo gjë nuk hynte pra në fushën e veprimit të nenit 6 § 1 të Konventës.

89. Por nga ana tjetër, disa herë, mungesa e një zgjidhjeje efektive në suazë procesesh zgjedhore është shqyrtuar në këndvështrimin e nenit 13 të Konventës. Gjykata ka vënë në dukje se, në fushën zgjedhore, mund të shihen si efektive vetëm ato zgjidhje që janë në gjendje të sigurojnë mirëfunksionimin e procesit demokratik (*Petkov me të tjerë k. Bullgarisë*). Në çështjen *Petkov me të tjerë k. Bullgarisë*, paditësit ishin fshirë nga listat e kandidatëve vetëm dhjetë ditë para mbajtjes së

votimit dhe mbi bazën e një ligji të nxjerrë më pak se tre muaj më parë. Këto vendime për fshirje ishin shpallur më pas të pavlefshme por, meqenëse autoritetet zgjedhore nuk i reregjistruan paditësit në listat e kandidatëve, ata nuk mundën të paraqiten në zgjedhje. Gjykata çmoi se, përderisa zgjidhja e disponueshme në suazën e zgjedhjeve ofronte vetëm një zhdëmtim financiar, ajo nuk mund të konsiderohej si efektive në vështrim të nenit 13 të Konventës. Në çështjen *Grosaru k. Rumanisë*, Gjykata vuri në dukje se paditësi, një kandidat i cili nuk kishte fituar në zgjedhjet legislative, nuk kishte mundur të siguronte asnjë kontroll gjyqësor të interpretimit të legjislacionit zgjedhor të kundërshtuar dhe doli në konkluzionin se kishte pasur shkelje të nenit 13 të bashkuar me nenin 3 të Protokollit nr. 1. Gjykata ka dalë gjithashtu në konkluzionin se kishte pasur shkelje të nenit 13 të bashkuar me nenin 3 të Protokollit nr. 1 në vendimin *Paunović e Milivojević k. Serbisë* që kishte të bënte me mungesën e një mundësie për ta kundërshtuar në mënyrë efektive shuarjen e paligjshme të një mandati deputeti (§§ 68-72).

90. Ekzistenca e një sistemi të brendshëm shqyrtimi efektiv ankesash e apelimesh individuale në fushën e të drejtave zgjedhore përbën një prej kushteve thelbësore që garantojnë zgjedhje të lira e të ndershme. Një sistem i tillë mundëson ushtrimin efektiv të së drejtës individuale për të votuar dhe të asaj për të qenë kandidat në zgjedhje. Ai e ruan besimin e përgjithshëm të publikut në mënyrën se si e organizojnë votimin autoritetet kombëtare. Ai përbën një mjet të rëndësishëm në dispozicion të shtetit në mënyrë që ky të mundë ta përmbushë detyrimin e tij pozitiv, të diktuar nga neni 3 i Protokollit nr. 1, për të mbajtur zgjedhje demokratike (*Uspaskich k. Lituanisë*, § 93).

91. Kur ekziston një zgjidhje, mangësitë e saj eventuale mund të parashtrohen para Gjykatës në këndvështrimin e nenit 3 të Protokollit nr. 1. Në fakt, mangësi të tilla mund të përbëjnë një shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 në qoftë se ato vënë në pikëpyetje paprekshmërinë e procesit zgjedhor. Procesi i vendimmarrjes lidhur me pazgjedhshmërinë ose me kundërshtimin e rezultateve zgjedhore duhet të jetë brenda kornizës së një minimumi garancish kundër arbitraritetit. Në veçanti, vendimet në fjalë duhet të merren nga një organ i cili paraqet një minimum garancish për paanësi. Po ashtu, kompetenca autonome për vlerësim e këtij organi nuk duhet të jetë e tepruar; ajo duhet të jetë, me përpikëri të mjaftueshme, brenda kornizës së dispozitave të së drejtës së brendshme. Së fundi, procedura duhet të jetë e tillë që të garantojë një vendim të drejtë, objektiv dhe mjaft të motivuar, si edhe të shmangë çdo shpërdorim detyre nga ana e autoritetit kompetent (*Podkolzina k. Letonisë*, § 35; *Kovach k. Ukrainës*, §§ 54-55; *Kerimova k. Azerbajxhanit*, §§ 44-45; *Riza me të tjerë k. Bullgarisë*, § 144). Kur i hyn një shqyrtimi të tillë, Gjykata mjaftohet gjithsesi duke përcaktuar nëse vendimi i dhënë nga organi i brendshëm ka pasur një karakter arbitrar ose haptazi të paarsyeshëm (*po aty*, § 144; *Kerimli e Alibeyli k. Azerbajxhanit*, §§ 38-42).

92. Vendimet për shpallje të një votimi si të pavlefshëm duhet t'i përgjigjen një pamundësie reale për të përcaktuar dëshirat e zgjedhësve (*Kovach k. Ukrainës*). Në çështjen *Kerimova k. Azerbajxhanit*, Gjykata vuri re se falsifikimet e kryera nga dy zyrtarë zgjedhorë nuk kishin arritur ta shtrembëronin rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, të fituara nga paditësja. Megjithatë, autoritetet kombëtare i kishin shpallur të pavlefshme rezultatet, në shkelje të së drejtës së brendshme zgjedhore dhe pa marrë parasysh përmasat e vogla të efekteve të falsifikimeve të lartpërmendura. Duke vepruar ashtu, autoritetet kombëtare u kanë ndihmuar në fakt zyrtarëve për ta bllokuar procesin zgjedhor. Ato i kanë cenuar në mënyrë arbitrare të drejtat zgjedhore të paditëses duke e penguar atë të marrë funksionet parlamentare. Gjykata doli andej në konkluzionin se kjo shpallje pavlefshmërie tregonte një mungesë konsiderate për paprekshmërinë e procesit zgjedhor, e cila nuk mund të pajtohej me frymën e së drejtës për zgjedhje të lira. Në fakt, roli i gjykatave nuk është kurrësi që të ndryshojnë shprehjen e popullit. Kështu, në dy çështje (*I.Z. k. Greqisë*, vendim i Komisionit; *Babenko k. Ukrainës* (vend. pran.)), organet e Konventës kanë shqyrtuar ankesa kandidatësh që kanë humbur në zgjedhje dhe që pretendojnë se procesi zgjedhor ka qenë i pandershëm, por i kanë rrëzuar ato për arsye të mungesës së ndonjë dëmi real për sa i përket rezultatit përfundimtar të votimit. Në çështjen *Riza me të tjerë k. Bullgarisë*, rezultatet e 23 qendrash votimi që ndodheshin jashtë shtetit ishin shpallur të pavlefshme për arsye parregullsish të pretenduara, çka solli konkretisht si pasojë heqjen e mandatit

të një deputeti. Gjykata i shqyrtoi aty njëherazi edhe ndërhyrjen në të drejtën e votës së 101 zgjedhësve, edhe atë në të drejtën për të qenë kandidat të deputetit të hequr dhe të partisë që ai përfaqësonte. Ajo vuri në dukje se, për t'i shpallur të pavlefshme zgjedhjet në disa qendra votimi, ishin dhënë vetëm disa arsye krejtësisht formale. Përveç kësaj, rrethanat e paraqitura nga gjykata për të arsyetuar vendimin e saj nuk figuronin, në mënyrë mjaft të qartë e të parashikueshme, në të drejtën e brendshme dhe nuk ishte vërtetuar që ato ta kishin shtrembëruar vullnetin e zgjedhësve e ndryshuar rezultatin e zgjedhjeve. Për më tepër, ligji zgjedhor nuk e parashikonte mundësinë për të organizuar zgjedhje të reja në ato qendra ku votimi ishte shpallur i pavlefshëm – në kundërshtim me rekomandimet e Kodit të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore të Komisionit të Venecias –, çka do të kishte bërë të mundur që të pajtohej qëllimi i drejtë i anulimit të rezultateve zgjedhore, konkretisht ruajtja e ligshmërisë së procesit zgjedhor, me të drejtat subjektive të zgjedhësve dhe të kandidatëve në zgjedhjet parlamentare. Për rrjedhojë, Gjykata doli në konkluzionin se kishte pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1. Vendimet për shpallje të një votimi si të pavlefshëm duhet t'i përgjigjen pra një pamundësie reale për të përcaktuar dëshirat e zgjedhësve.

93. Megjithatë, shtetet duhet të kujdesen që ankesat e pranueshme për parregullsi zgjedhore të cilat paraqiten prej individëve të shqyrtohen me të vërtetë dhe që vendimet të arsyetohen në mënyrë të mjaftueshme. Duke u mbështetur në veçanti te Kodi i praktikës së mirë në çështjet zgjedhore i Komisionit të Venecias, Gjykata ka pasur rastin të gjykojë se disa autoritete kombëtare kishin treguar një formalizëm të tepruar që kishte çuar në rrëzimin e një ankimi në fushën zgjedhore. Fakti se kandidatët i ndan një diferencë e madhe votash ka pak rëndësi, kur është më mirë që të vlerësohen veçmas serioziteti dhe përmasat e parregullsive para se të përcaktohen efektet e tyre mbi rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve (*Namat Aliyev k. Azerbajxhanit*).

Lista e çështjeve të cituara

Jurisprudenca e cituar në këtë udhëzues u referohet disa vendimeve të dhëna nga Gjykata, si edhe disa vendimeve e raporteve të Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut (“Komisioni”).

Përveçse kur ka ndonjë shënim të veçantë të vënë pas emrit të çështjes, referenca e cituar është ajo e një vendimi për themelin të dhënë nga një dhomë e Gjykatës. Shënimi “(vend. pran.)” i referohet një vendimi për pranueshmërinë të Gjykatës, kurse shënimi “[DhM]” do të thotë se çështja është gjykuar nga Dhoma e Madhe.

Hiperlidhjet e çështjeve të cituara në versionin elektronik të këtij udhëzuesi shpjen drejt bazës së të dhënave HUDOC (<<http://hudoc.echr.coe.int>>), e cila lejon qasje në jurisprudencën e Gjykatës (vendime Dhome të Madhe, Dhome e Komiteti, çështje të njoftuara, mendime këshillimore dhe përmbledhje juridike të nxjerra nga Shënimet informativ rreth jurisprudencës), si edhe në atë të Komisionit (vendime dhe raporte) e në rezolutat e Komitetit të Ministrave. Disa vendime të Komisionit nuk figurojnë në bazën e të dhënave HUDOC dhe mund të gjenden vetëm në version të shtypur në vëllimin përkatës të Vjetarit të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Gjykata i jep vendimet e saj në anglisht dhe/ose në frëngjisht, dy gjuhët e saj zyrtare. Baza e të dhënave HUDOC jep gjithashtu qasje te përkthime të disa prej çështjeve kryesore të Gjykatës në mbi tridhjetë gjuhë jozyrtare. Përveç kësaj, ajo përmban lidhje drejt rreth njëqind përmbledhjesh jurisprudence në linjë të prodhuara nga të tretë.

—A—

Ādamsons k. Letonisë, nr. 3669/03, 24 qershor 2008

Ahmed me të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar, 2 shtator 1998, Përmbledhje e vendimeve 1998-VI

Alajos Kiss k. Hungarisë, nr. 38832/06, 20 maj 2010

Albanese k. Italisë, nr. 77924/01, 23 mars 2006

Anchugov e Gladkov k. Rusisë, nr. 11157/04 e 15162/05, 4 korrik 2013

Antonenko k. Rusisë (vend. pran.), nr. 42482/02, 23 maj 2006

Asensio Serqueda k. Spanjës (vend. pran.), nr. 23151/94, vendim i Komisionit i 9 majit 1994, Vendime dhe raporte 77

Aziz k. Qipros, nr. 69949/01, GjEDNj 2004-V

—B—

Babenko k. Ukrainës (vend. pran.), nr. 43476/98, 4 maj 1999

Benkaddour k. Francës (vend. pran.), nr. 51685/99, 10 nëntor 2003

Bompard k. Francës (vend. pran.), nr. 44081/02, GjEDNj 2006-IV

Boškoski k. ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (vend. pran.), nr. 11676/04, GjEDNj 2004-VI

Bowman k. Mbretërisë së Bashkuar, 19 shkurt 1998, Përmbledhje e vendimeve 1998-I

Brike k. Letonisë (vend. pran.), nr. 47135/99, 29 qershor 2000

Brito Da Silva Guerra e Sousa Magno k. Portugalisë (vend. pran.), nr. 26712/06 e 26720/06, 17 qershor 2008

—D—

Dicle e Sadak k. Turqisë, nr. 48621/07, 16 qershor 2015
Doyle k. Mbretërisë së Bashkuar (vend. pran.), nr. 30158/06, 6 shkurt 2007
Dunn me të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar (vend. pran.), nr. 566/10 e 130 të tjerë, 13 maj 2014
Dupré k. Francës (vend. pran.), nr. 77032/12, 3 maj 2016

—E—

Ekoglasnost k. Bullgarisë, nr. 30386/05, 6 nëntor 2012
Etxeberria me të tjerë k. Spanjës, nr. 35579/03 e 3 të tjerë, 30 qershor 2009

—F—

Federación Nacionalista Canaria k. Spanjës (vend. pran.), nr. 56618/00, GjEDNj 2001-VI
Frodl k. Austrisë, nr. 20201/04, 8 prill 2010

—G—

Geraguyn Khorhurd Patgamavorakan Akumb k. Armenisë (vend. pran.), nr. 11721/04, 14 prill 2009
Gitonas me të tjerë k. Greqisë, 18747/91, 1 qershor 1997, Përmbledhje e vendimeve 1997-IV
Greens e M.T. k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 60041/08 e 60054/08, GjEDNj 2010 (pjesë të zgjedhura)
Grosaru k. Rumanisë, nr. 78039/01, GjEDNj 2010

—H—

Hilbe k. Lihtenshtajnit (vend. pran.), 31981/96, GjEDNj 1999-VI
Hirst k. Mbretërisë së Bashkuar (nr. 2) [DhM], 74025/01, GjEDNj 2005-IX

—I—

I.Z. k. Greqisë, nr. 18997/91, vendim i Komisionit i 28 shkurtit 1994, Vendime dhe raporte 76

—K—

Kavakçı k. Turqisë, nr. 71907/01, 5 prill 2007
Kerimli e Alibeyli k. Azerbajxhanit, nr. 18475/06 e 22444/06, 10 janar 2012
Kerimova k. Azerbajxhanit, nr. 20799/06, 30 shtator 2010
Kovatch k. Ukrainës, nr. 39424/02, GjEDNj 2008
Krasnov e Skouratov k. Rusisë, nr. 17864/04 e 21396/04, 19 korrik 2007

—L—

Labita k. Italisë [DhM], nr. 26772/95, GjEDNj 2000-IV
Linkov k. Republikës Çeke, nr. 10504/03, 7 dhjetor 2006
Luksch k. Gjermanisë, nr. 35385/97, vendim i Komisionit i 21 majit 1997

Lykourezos k. Greqisë, nr. 33554/03, GjEDNj 2006-VIII

—M—

M. k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 10316/83, vendim i Komisionit i 7 marsit 1984, Vendime dhe raporte 37

Malarde k. Francës (vend. pran.), nr. 46813/99, 5 shtator 2000

Mathieu-Mohin e Clerfayt k. Belgjikës, 2 mars 1987, seria A nr. 113

Matthews k. Mbretërisë së Bashkuar [DhM], nr. 24833/94, GjEDNj 1999-I

Melnitchenko k. Ukrainës, nr. 17707/02, GjEDNj 2004-X

Mihaela Mihai Neagu k. Rumanisë (vend. pran.), nr. 66345/09, 6 mars 1994

Mółka k. Polonisë (vend. pran.), nr. 56550/00, GjEDNj 2006-IV

—N—

Namat Aliyev k. Azerbajxhanit, nr. 18705/06, 8 prill 2010

—O—

Occhetto k. Italisë (vend. pran.), nr. 14507/07, 12 nëntor 2013

Oran k. Turqisë, nr. 28881/07 e 37920/07, 15 prill 2014

—P—

Paksas k. Lituanisë [DhM], nr. 34932/04, GjEDNj 2011 (pjesë të zgjedhura)

Partei Die Friesen k. Gjermanisë, nr. 65480/10, 28 janar 2016

Parti nacionaliste basque – Organisation régionale d’Iparralde k. Francës, nr. 71251/01, GjEDNj 2007-II

Partia e Punës e Gjeorgjisë k. Gjeorgjisë, nr. 9103/04, GjEDNj 2008

Partia Komuniste e Njësuar e Turqisë me të tjerë k. Turqisë, 30 janar 1998, Përmbledhje e vendimeve 1998-I

Partia Komuniste e Ruisë me të tjerë k. Ruisë, nr. 29400/05, 19 qershor 2012

Partia Konservatore Ruse e Sipërmarrësve me të tjerë k. Ruisë, nr. 55066/00 e 55638/00, 11 janar 2007

Partia Socialiste me të tjerë k. Turqisë, 25 maj 1998, Përmbledhje e vendimeve 1998-III

Partija “Jaunie Demokrāti” e Partija “Mūsu Zeme” k. Letonisë (vend. pran.), nr. 10547/07 e 34049/07, 29 nëntor 2007

Paschalidis, Koutmeridis e Zaharakis k. Greqisë, nr. 27863/05 e 2 të tjerë, 10 prill 2008

Paunović e Milivojević k. Serbisë, nr. 41683/06, 24 maj 2016

Petkov me të tjerë k. Bullgarisë, nr. 77568/01 e 2 të tjerë, 11 qershor 2009

Pierre-Bloch k. Francës, nr. 24194/94, 21 tetor 1997

Podkolzina k. Letonisë, nr. 46726/99, GjEDNj 2002-II

Polacco e Garofalo k. Italisë, nr. 23450/94, vendim i Komisionit i 15 shtatorit 1997

Py k. Francës, nr. 66289/01, GjEDNj 2005-I (pjesë të zgjedhura)

—R—

Refah Partisi (Partia e Begatisë) me të tjerë k. Turqisë [DhM], nr. 41340/98 e 3 të tjerë, GjEDNj 2003-II

Riza me të tjerë k. Bullgarisë, nr. 48555/10 e 48377/10, 13 tetor 2015

—S—

Sadak me të tjerë k. Turqisë (nr. 2), nr. 25144/94 e 8 të tjerë, GjEDNj 2002-IV

Salleras Llinares k. Spanjës (vend. pran.), nr. 52226/99, GjEDNj 2000-XI

Scoppola k. Italisë (nr. 3) [DhM], nr. 126/05, 22 maj 2012

Sejdić e Finci k. Bosnjë-Hercegovinës [DhM], nr. 27996/06 e 34836/06, GjEDNj 2009

Sevinger k. Vendeve të Ulëta (vend. pran.), nr. 17173/07 e 17180/07, 6 shtator 2007

Seyidzade k. Azerbajxhanit, nr. 37700/05, 3 dhjetor 2009

Shindler k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 19840/09, 7 maj 2013

Sitaropoulos e Giakoumopoulos k. Greqisë [DhM], nr. 42202/07, 2012

Sobacı k. Turqisë, nr. 26733/02, 29 nëntor 2007

Soukhovetski k. Ukrainës, nr. 13716/02, GjEDNj 2006-VI

Söyler k. Turqisë, nr. 29411/07, 17 shtator 2013

Staatkundig Gereformeerde Partij k. Vendeve të Ulëta (vend. pran.), nr. 58369/10, 10 korrik 2012

Strack e Richter k. Gjermanisë (vend. pran.), nr. 28811/12 e 50303/12, 5 korrik 2016

—T—

Tahirov k. Azerbajxhanit, nr. 31953/11, 11 qershor 2015

Tănase k. Moldavisë [DhM], nr. 7/08, GjEDNj 2010

Timke k. Gjermanisë, nr. 27311/95, vendim i Komisionit i 11 shtatorit 1995

TV Vest AS e Rogaland Pensjonistparti k. Norvegjisë, nr. 21132/05, GjEDNj 2008 (pjesë të zgjedhura)

—U—

Uspaskich k. Lituanisë, nr. 14737/08, 20 dhjetor 2016

—V—

Vito Sante Santoro k. Italisë, nr. 36681/97, GjEDNj 2004-VI

Vitrenko me të tjerë k. Ukrainës, nr. 23510/02, 16 dhjetor 2008

—X—

X. k. Gjermanisë, nr. 2728/66, vendim i Komisionit i 6 tetorit 1967, Seria e botimeve 25

X. k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 7140/75, vendim i Komisionit i 6 tetorit 1976, Vendime dhe raporte 7

X. k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 7566/76, vendim i Komisionit i 11 dhjetorit 1976, Vendime dhe raporte 9

X. k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 7730/76, vendim i Komisionit i 28 shkurtit 1979, Vendime dhe raporte 15

X. k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 8873/80, vendim i Komisionit i 13 majit 1982, Vendime dhe raporte 28

X. me të tjerë k. Belgjikës, nr. 6837/74, vendim i Komisionit i 2 tetorit 1975, Vendime dhe raporte 3

Xuereb k. Maltës, nr. 52492/99, 15 qershor 2000

—Y—

Yumak e Sadak k. Turqisë [DhM], nr. 10226/03, GjEDNj 2008

—Z—

Ždanoka k. Letonisë [DhM], nr. 58278/00, GjEDNj 2006-IV

Zornić k. Bosnjë-Hercegovinës, nr. 3681/06, 15 korrik 2014